FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 6

Tiranë – E hënë, 16 janar 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 86/2022, datë 22.12.2022	Për vreshtarinë dhe verën	577
Dekret i Presidentit nr. 6, datë 11.1.2023	Për shpallje ligji	596
Ligj nr. 89/2022, datë 22.12.2022	Për Policinë Bashkiake	597
Dekret i Presidentit nr. 5, datë 11.1.2023	Për shpallje ligji	609
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 11.1.2023	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara	609

LIGJ
Nr. 86/2022

PËR VRESHTARINË DHE VERËN[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim:

a) vendosjen e rregullave për kultivimin e vreshtave që përdoren për prodhimin e verës, regjistrin e vreshtarisë, prodhimin, etiketimin, marketingun, potencialin e prodhimit dhe kontrollet e produkteve të verës në Republikën e Shqipërisë, për përshtatjen me kërkesat dhe standardet e tregut ndërkombëtar;

b) mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke ruajtur një konkurrencë të drejtë ndërmjet prodhuesve dhe operatorëve të tjerë në sektorin e verës;

c) nxitjen e përmirësimit të cilësisë së produkteve me marrjen e masave kombëtare për politikën e cilësisë në sektorin e verës.

2. Ky ligj zbatohet nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që zhvillojnë në Shqipëri aktivitete ekonomike që lidhen me qëllimin e ligjit, duke përfshirë prodhimin, tregtimin, eksportin dhe importin e produkteve të mbuluara nga sektori i verës.

3. Ky ligj nuk zbatohet për produktet e verës që nuk janë për shitje.

Neni 2
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë ligj kanë këto kuptime:

1. "Produktet e sektorit të verës" janë produktet e mbuluara nga kodet e mëposhtme të nomenklaturës së kombinuar të mallrave:

a) 2009 61, 2009 69, "Lëng rrushi" (përfshirë mushtin e rrushit);

b) 2204 30 92, 2204 30 94, 2204 30 96, 2204 30 98, "Musht tjetër rrushi", përveç atyre në fermentim apo me fermentim të penguar ndryshe nga shtesa e alkoolit;

[1] "Ky ligj është përafruar pjesërisht me:
- Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, "Për krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007", e ndryshuar. Numri CELEX 32013R1308, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, f .671–854.
-Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/934, datë 12 mars 2019, "Për plotësimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me zonat e verës ku mund të rritet fortësia alkoolike, praktikat e autorizuara enologjike dhe kufizimet e zbatueshme për prodhimin dhe konservimin e produkteve të rrushit për verë, përqindjen minimale të alkoolit për nënproduktet dhe asgjësimin e tyre, dhe publikimin e dosjeve OIV", e ndryshuar." Numri CELEX 32019R0943, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 149, datë 7.6.2019, f. 1–52.
- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/33, datë 17 tetor 2018, "Për plotësimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe termave tradicionalë në sektorin e verës, procedura e kundërshtimit, kufizimet e përdorimit, ndryshimet në specifikimet e produktit, anulimi i mbrojtjes, dhe etiketimi dhe prezantimi." Numri CELEX 32019R0033, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 9, datë 11.1.2019, f. 2–45.
- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2018/273, datë 11 dhjetor 2017, "Për plotësimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e hardhive, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistri i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me kontrollet dhe gjobat përkatëse, që ndryshon Rregulloret e Komisionit (KE) nr. 555/2008, (KE) nr. 606/2009 dhe (KE) nr. 607/2009, dhe që shfuqizon Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009 dhe Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2015/560", të ndryshuar. Numri CELEX 32018R0273, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 58, datë 28.2.2018, f. 1–59.
- Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/34, datë 17 tetor 2018, "Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe termave tradicionale në sektorin e verës, procedurën e kundërshtimit, ndryshimet në specifikimet e produktit, regjistrin e emrave të mbrojtur, anulimin e mbrojtjes dhe përdorimin e simboleve dhe Rregullores (BE) nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me një sistem të përshtatshëm të kontrolleve". Numri CELEX 32019R0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 9, datë 11.1.2019, f. 46–76.
- Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/274, datë 11 dhjetor 2017, "Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e hardhive, certifikimin, regjistrin e hyrje-daljeve, deklaratat dhe njoftimet e detyrueshme dhe të Rregullores (BE) nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me kontrollet përkatëse, dhe që shfuqizon Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2015/561", e ndryshuar. Numri CELEX 32018R0274, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 58, datë 28.2.2018, f. 60–95.
- Direktivën 2007/45/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 5 shtator 2007 "Për vendosjen e rregullave mbi sasitë nominale për produktet e paketuara, që shfuqizon Direktivat e Këshillit 75/106/KEE dhe 80/232/KEE dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 76/211/KEE." Numri CELEX 32007L0045, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 247, datë 21.9.2007, f. 17–20.

c) ex 22 04, "Verë prej rrushit të freskët", përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi, përveç atij të kreut 2009, me përjashtim të mushtit tjetër të rrushit të nënkreut 2204 30 92, 2204 30 94, 2204 30 96 dhe 2204 30 98;

ç) 0806 10 90 "Rrush i freskët", i ndryshëm nga rrushi i tavolinës;

d) 2209 00 11, 2209 00 19 "Uthull vere";

dh) 2206 00 10, "*Piquette*" (verë bërsie);

e) 2307 00 11, 2307 00 19, "Llum vere";

ë) 2308 00 11, 2308 00 19, "Bërsi rrushi".

"f) ex 2202 99 19 - tjetër, "verë e dealkolizuar" me fortësi alkoolike jo më shumë se 0,5% vol.

2. "Produktet e verës" janë produktet e pikës 1 të këtij neni, shkronjat nga "a"– "ç" dhe nga "dh"-"f";

3. "Kadastra e vreshtave" është baza e të dhënave lidhur me vreshtat në territorin e Republikës së Shqipërisë;

4. "Kupazhim" është përzierje e llojeve të ndryshme verërash për të marrë një verë me karakteristikat e dëshiruara;

5. "Zonat e prodhimit të rrushit" janë sipërfaqe të përshtatshme toke për mbjelljen e vreshtave;

6. "Laboratorë të autorizuar" janë laboratorë privatë ose publikë, që autorizohen me urdhër ministri për kryerjen e analizave fiziko-kimike, marrjen e mostrës, cilësinë e produkteve të rrushit për verë;

7. "Produktet e rrushit për verë" janë produktet e listuara në pikën 13 të këtij neni;

8. "Vit vere" është periudha 1 gusht deri më 31 korrik të vitit pasardhës;

9. Terma që lidhen me vreshtin:

a) "Shkulje" është eliminimi tërësor i rrënjëve të hardhisë në një sipërfaqe toke të mbjellë me hardhi (vresht);

b) "Mbjellje" është krijimi i një vreshti ose i një pjese të vreshtit, qoftë ky vresht me hardhi të nënshartuara ose jo, me qëllim prodhimin e rrushit ose krijimin e një fidanishteje me bimë mëmë, ku bëhet përzgjedhja e bimëve për shartesa;

c) "Rishartim" është shartimi i një bime hardhie, e cila ka qenë më parë e shartuar;

ç) "Kultivim" është procesi i plotë që përfshin mbjelljen e kujdesin ndaj bimëve, rishartimin dhe proceset e tjera gjatë fazës që bima përdoret për prodhim.

10. Terma të lidhur me prodhimin:

a) "Rrush i freskët" janë frutat ose veshulët që përdoren në procesin e bërjes së verës, të pjekura ose të tejpjekura, të cilat mund të dërrmohen ose të shtypen me pajisje specifike ose fizikisht nga vetë njeriu, në kantinë dhe që mund t'i nënshtrohen fermentimit alkoolik;

b) "Musht rrushi i freskët pjesërisht i fermentuar" është produkti, i cili:

i. ka një fortësi alkoolike aktuale jo më pak se 12% vol. dhe jo më shumë se 15% vol.;

ii. përftohet duke shtuar në mushtin e rrushit të pafermentuar, i cili ka një fortësi alkoolike efektive jo më pak se 8,5% vol. dhe e ka prejardhjen ekskluzivisht nga varietet e hardhive për prodhimin e produkteve të verës:

- ose të alkoolit neutral me origjinë nga vera, që përfshin alkoolin e përftuar nga distilimi i rrushit të thatë, që ka një fortësi alkoolike jo më pak se 96% vol.;

- ose të një produkti alkoolik të padistiluar me origjinë nga vera dhe ka një fortësi alkoolike efektive jo më pak se 52% vol. e jo më shumë se 80% vol.

c) "Lëng rrushi" është produkti i lëngët, i pafermentuar, me fortësi alkoolike efektive jo më shumë se 1% vol., produkt, i cili:

i. përftohet nga trajtimi i duhur (procese fizike të autorizuara), i cili e bën atë të përshtatshëm për konsum siç është;

ii. përftohet nga rrushi i freskët, nga mushti i rrushit ose nga lëngu i holluar i rrushit me procesin fizik të ripërbërjes. Në rastet kur ky proces përftohet nga hollimi, ai përftohet nga mushti i rrushit i përqendruar ose lëngu i rrushit i përqendruar.

ç) "Lëng rrushi i përqendruar" është lëngu i rrushit i pakaramelizuar i përftuar nga dehidratimi i pjesshëm i lëngut të rrushit me metodat e autorizuara, përveç ngrohjes direkte, në mënyrë që vlera e treguar nga refraktometri i përdorur në përputhje me një metodë të këshilluar në temperaturën 20°C të jetë jo më pak se 50,9% dhe me fortësi alkoolike efektive jo më shumë se 1% vol.;

d) "Llum vere" janë mbetjet që:

i. grumbullohen në enët që mbajnë verën pas fermentimit, gjatë ruajtjes ose pas përpunimit teknologjik të autorizuar (ose të përftuara nga filtrimi ose centrifugimi i këtyre produkteve);

ii. grumbullohen në enët që mbajnë musht rrushi gjatë ruajtjes ose pas trajtimit të autorizuar ose të përftuara nga filtrimi ose centrifugimi i këtyre produkteve.

dh) "Bërsi rrushi" janë mbetjet nga shtypja/ presimi i rrushit të freskët, i fermentuar ose jo;

e) "Vera e bërsisë *Piquette*" është produkti i përftuar nga:

i. fermentimi i bërsive të rrushit të patrajtuara, të zhytura në ujë; ose

ii. kullimi i bërsive të fermentuara të rrushit me ujë.

ë) "Verë e forcuar me alkool për distilim", është produkti, i cili:

i. ka fortësi alkoolike efektive jo më pak se 18% vol dhe jo më shumë se 24% vol.;

ii. përftohet ekskluzivisht duke shtuar në një verë që nuk përmban mbetje sheqeri një produkt të pakorrigjuar të përftuar nga distilimi i verës dhe që ka fortësi alkoolike aktuale 86% vol.; ose

iii. ka aciditet të avullueshëm maksimalisht 1,5 gramë për litër, të shprehur si acid acetik.

f) "*Cuvée*" (masë përzierje vere) është mushti i rrushit, vera ose përzierja e mushtit të rrushit dhe/ose e verërave me karakteristika të ndryshme, të përcaktuara me qëllim përgatitjen e një lloji të veçantë vere me gaz.

11. Terma që lidhen me fortësinë alkoolike:

a) "Fortësia alkoolike efektive sipas vëllimit" është numri i vëllimeve të alkoolit të pastër të pranishëm në temperaturë 20°C në 100 njësi vëllimore të produktit në të njëjtën temperaturë;

b) "Fortësia alkoolike potenciale sipas vëllimit" është numri i vëllimeve të alkoolit të pastër në temperaturë 20°C, që mund të prodhohet nga fermentimi total i sheqernave në 100 njësi vëllimore të produktit në po këtë temperaturë;

c) "Fortësia alkoolike totale sipas vëllimit" është shuma e fortësisë alkoolike efektive dhe e asaj potenciale;

ç) "Fortësia alkoolike natyrale sipas vëllimit" është fortësia alkoolike totale në njësi vëllimore të një produkti përpara çdo lloj pasurimi;

d) "Fortësia alkoolike aktuale në njësi mase" është numri i kilogramëve të alkoolit të pastër në 100 kg produkt;

dh) "Fortësia alkoolike potenciale në njësi mase" është numri i kilogramëve të alkoolit të pastër që mund të prodhohet nga fermentimi total i sheqernave në 100 kg produkt;

e) "Fortësia alkoolike totale në njësi mase" është shuma e fortësisë alkoolike efektive dhe e asaj potenciale në njësi mase.

12. Terma që kanë lidhje me etiketimin dhe treguesit gjeografikë:

a) "Etiketim" janë fjalët, veçoritë, markat tregtare, emri tregtar, imazhi ose simboli i vendosur në ambalazhe, dokumente, shënime, etiketa, unaza ose shirita të printuar që shoqërojnë ose që i referohen një produkti të caktuar;

b) "Paraqitje" është çdo informacion që u përcillet konsumatorëve nëpërmjet ambalazhit të produktit në fjalë, duke përfshirë formën dhe llojin e shisheve;

c) "Emërtim origjine të mbrojtur" është i njëjti kuptim i dhënë në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, në vijim "EOM", përdorur për produktet e përcaktuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1; 20.3–20.6; 20.8; 20.9; 20.11; 20.15 dhe 20.16, të këtij ligji;

ç) "Tregues gjeografikë të mbrojtur" është i njëjti kuptim i dhënë në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, në vijim "TGJM", përdorur për produktet e përcaktuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1; 20.3–20.6; 20.8; 20.9; 20.11; 20.15 dhe 20.16 të këtij ligji;

d) "Termi tradicional" është termi i përdorur tradicionalisht për produktet e përcaktuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1; 20.3–20.6; 20.8; 20.9; 20.11; 20.15 dhe 20.16, të këtij ligji, për të treguar metodën e prodhimit ose të vjetrimit, ose cilësinë, ngjyrën, kushtet e vendit, ose një ngjarje të veçantë të lidhur me historinë e produktit me EOM-në ose me TGJM-në.

13. Terma që kanë lidhje me operatorët:

a) "vreshtar" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave që ka një sipërfaqe të mbjellë me hardhi, ku prodhimi i kësaj zone përdoret për prodhimin tregtar të produkteve të verës;

b) "vjelës" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, që vjel rrushin e prodhuar nga një zonë e mbjellë me vresht, me qëllim tregtimin e rrushit për prodhimin e produkteve të verës nga palë të treta, ose për t'i përpunuar në produkte vere në njësinë e tij, ose t'i përpunojë në emër të tij për qëllime tregtare;

c) "prodhues" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, që përpunon rrush

të freskët, musht ose verë të re ende në fermentim, për prodhim vere ose mushti për qëllime tregtare, ose që e përpunon në emër të tij;

ç) "përpunues" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, nga i cili ose në emër të të cilit është kryer përpunimi i verërave, rezultati i të cilit janë verërat e përfunduara, verërat e fortifikuara (forcuar me alkool), verërat me gaz dhe pjesërisht të gazuara, verërat e gazuara të ajrosura dhe pjesërisht të gazuara, verërat me gaz të cilësisë ose verërat me gaz cilësore aromatike;

d) "shitës me pakicë" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, veprimtaria ekonomike e të cilit përfshin shitjen direkt te konsumatori të verës dhe mushtit, në sasi vjetore jo më të mëdha se 1 000 hl për vit vere, duke përjashtuar personat që përdorin kantinat e pajisura për ruajtjen ose pajisje për mbushjen e shisheve me verë në sasi të mëdha dhe ata që merren me tregtinë e verës që transportohet me shumicë;

dh) "mbushës shishesh" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, që kryen procesin e mbushjes së shisheve të verës ose ky proces kryhet në emër të tij;"

e) "tregtar" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, përveç konsumatorëve privatë ose shitës me pakicë, i cili mban stoqe të produkteve të verës me qëllime tregtare ose është i përfshirë në tregtinë e tyre, i cili mund të kryejë procesin e mbushjes së shisheve me produktet e verës, përveç distilerive;

Shkronjat "dh" dhe "e" kanë të njëjtën referencë me nenin 2 të ligjit nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

14. "Parcelë vreshti" është një territor unik toke i mbjellë me hardhi ose që ka për qëllim prodhimin tregtar të produkteve të verës ose përfitojnë nga përjashtimet për qëllime eksperimentale ose për fidanishte;

15. "Vreshta heroike" janë vreshtat që janë mbjellë në terrene të pjerrëta; në zona të rrezikuara nga paqëndrueshmëria hidrogjeologjike; që janë të vendosura në zona ku kushtet orografike krijojnë pengesa për mekanizimin, ose të cilat kanë dobi të veçantë peizazhi dhe ambientale dhe identifikohen si të tilla në bazë të plotësimit të paktën të një prej karakteristikave të mëposhtme:

i. pjerrësia e tokës është më e madhe se 30%;

ii. lartësia mesatare mbi 500 metër mbi nivelin e detit;

iii. rregullimi i sistemit të vreshtave dhe kultivimi i tyre në tarraca ose shkallë.

16. "Praktikat enologjike" janë praktikat dhe proceset teknologjike të lejuara sipas procedurave ndërkombëtare OIV, që zhvillohen në prodhimin e verës dhe të produkteve të veçanta të përftuara nga vera, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

17. "Varietet" është i njëjti kuptim si në legjislacionin në fuqi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor;

18. "Kultivar autokton" është kultivari i cili është i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë që në kohë të hershme, referuar të dhënave të Bankës Gjenetike, si dhe, falë veçorive klimatiko-tokësore të një zone të caktuar, ka përfituar karakteristika të veçanta unike të asaj zone.

19. "Kultivar aulokton" është kultivari i cili është i përhapur në territore të ndryshme nga ai i origjinës dhe ruan karakteristikat e veçanta varietale.

20. "Kategoritë e produkteve të përftuara nga përpunimi i rrushit për verë" ka kuptimin si më poshtë dhe ndahen në:

20.1 "Verë" është produkti i përftuar vetëm nga fermentimi alkoolik i plotë ose i pjesshëm i rrushit të freskët, qoftë i shtypur ose jo, ose i mushtit të rrushit, që ka:

a) fortësi alkoolike efektive jo më pak se 8.5% vol.;

b) fortësi alkoolike totale jo më shumë se 16% vol. Përjashtimisht nga ky parashikim, kufiri i sipërm për fortësinë alkoolike totale mund të arrijë deri në 17.5% vol. për verëra, të cilat janë prodhuar pa pasurim.

20.2 "Vera e re ende në fermentim" është produkti në të cilin nuk ka përfunduar ende fermentimi alkoolik dhe i cili nuk është ndarë ende nga llumrat;

20.3 "Verë e fortifikuar likeroze" është produkti, i cili:

a) ka fortësi alkoolike efektive jo më pak se 15% vol. dhe jo më shumë se 22% vol.;

b) përftohet nga:

- mushti i rrushit pjesërisht i fermentuar;
- vera;
- një kombinim i mushtit të rrushit pjesërisht të fermentuar dhe verës.

c) ka fortësi fillestare alkoolike natyrore jo më pak se 12% vol.;

ç) i janë shtuar:

i. veçmas ose në kombinim:

- alkool asnjanës me origjinë nga rrushi, duke përfshirë alkoolin e përftuar nga distilimi i rrushit të thatë, që ka fortësi alkoolike efektive jo më pak se 96% vol.;

- distilatë verë ose rrushi të thatë që ka fortësi alkoolike efektive jo më pak se 52% vol. dhe jo më shumë se 86% vol.

ii. së bashku me një ose më shumë prej produkteve të mëposhtme, kur është e përshtatshme:

- musht rrushi i përqendruar;

- musht i rrushit të tharë me metoda të lejuara;

- një kombinim i njërit prej produkteve të përcaktuara në nënndarjen "i" të kësaj shkronje, me mushtin e rrushit në fermentim.

20.4 "Verë e gazuar shkumbëzuese" është produkti:

a) i cili përftohet nga fermentimi i parë ose i dytë alkoolik:

- nga rrushi i freskët;

- nga mushti i rrushit; ose

- nga vera.

b) i cili, kur hapet ena, çliron dyoksid karboni të përftuar ekskluzivisht nga fermentimi;

c) i cili, për shkak të dyoksidit të karbonit në tretësirë, ka një presion të tepërt jo më pak se 3 bar kur mbahet në temperaturë 20ºC në enë të mbyllura; dhe

ç) për të cilin fortësia alkoolike totale e *Cuvée*-së, e synuar për përgatitjen e saj, nuk është më e vogël se 8,5% vol.

20.5 "Verë e gazuar shkumbëzuese cilësore" është produkti:

a) që përftohet nga fermentimi i parë ose i dytë alkoolik:

- nga rrushi i freskët;

- nga mushti i rrushit; ose

- nga vera.

b) i cili, kur hapet ena, çliron dyoksid karboni të përftuar ekskluzivisht nga fermentimi;

c) i cili për shkak të dyoksidit të karbonit në tretësirë ka një presion të tepërt jo më pak se 3,5 bar, kur mbahet në temperaturë 20ºC në enë të mbyllura; dhe

ç) për të cilin fortësia alkoolike totale e *Cuvée*-së, e synuar për përgatitjen e saj, nuk është më e vogël se 9% vol.

20.6 "Verë e gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike" është vera cilësore e gazuar:

a) që përftohet vetëm duke përdorur gjatë përgatitjes së *Cuvée*-së musht rrushi ose musht rrushi në fermentim të përftuar nga varietetet specifike të rrushit për verë;

b) e cila, për shkak të dyoksidit të karbonit në tretësirë, ka një presion të tepërt jo më pak se 3 bar kur mbahet në temperaturë 20ºC në enë të mbyllura;

c) fortësia alkoolike aktuale e së cilës nuk mund të jetë më pak se 6% vol.; dhe

ç) fortësia alkoolike totale e së cilës nuk mund të jetë më pak se 10% vol.

20.7 "Verë e gazifikuar shkumbëzuese" është produkti që:

a) përftohet nga vera pa emërtim të origjinës së mbrojtur ose tregues gjeografik të mbrojtur;

b) kur ena është e hapur, lëshon dyoksid karboni të përftuar plotësisht ose pjesërisht nga shtimi i atij gazi; dhe

c) për shkak të dyoksidit të karbonit në tretësirë të induktuar ka një presion të tepërt jo më pak se 3 bar, kur mbahet në temperaturë 20ºC në enë të mbyllura.

20.8 "Verë pjesërisht e gazuar" është produkti që:

a) përftohet nga vera, vera e re ende në fermentim, mushti i rrushit ose mushti i rrushit në fermentim për sa kohë që këto produkte kanë një fortësi totale alkoolike të paktën 9% vol.;

b) ka fortësi alkoolike aktuale jo më pak se 7% vol.;

c) për shkak të dyoksidit të karbonit endogjen brenda në tretësirë, ka presion të tepërt jo më pak se 1 bar dhe jo më shumë se 2,5 bar kur mbahet në temperaturë 20ºC në enë të mbyllura; dhe

ç) është futur në enë me kapacitet 60 litra ose më pak.

20.9 "Verë e gazifikuar" është produkti, që:

a) përftohet nga vera, vera e re ende në fermentim, mushti i rrushit ose mushti i rrushit në fermentim;

b) ka fortësi alkoolike aktuale jo më pak se 7% vol. dhe fortësi alkoolike totale jo më pak se 9% vol.;

c) për shkak të dyoksidit të karbonit në tretësirë, të shtuar plotësisht ose pjesërisht, ka presion të tepërt jo më pak se 1 bar dhe jo më shumë se 2,5 bar kur mbahet në temperaturë 20°C në enë të mbyllura; dhe

ç) është futur në enë me kapacitet 60 litra ose më pak.

20.10 "Mushti i rrushit" është produkti i lëngët i përftuar nga rrushi i freskët në mënyrë natyrale ose nëpërmjet proceseve fizike. Vlera e lejuar e fortësisë alkoolike aktuale e mushtit të rrushit është jo më shumë se 1% vol.;

20.11 "Musht rrushi pjesërisht i fermentuar" është produkti i përftuar nga fermentimi i mushtit të rrushit me fortësi alkoolike aktuale mbi 1% vol., por më pak se tre të pestat e fortësisë alkoolike totale të tij sipas vëllimit;

20.12 "Musht rrushi pjesërisht i fermentuar i përftuar nga rrushi i tharë" është produkti i përftuar nga fermentimi i pjesshëm i mushtit të përftuar nga rrushi i tharë, përmbajtja totale e sheqerit të të cilit është të paktën 272 gramë për litër para fermentimit dhe fortësia alkoolike natyrale dhe efektive e të cilit nuk është më e vogël se 8% vol.;

20.13 "Mushti i rrushit i përqendruar" është mushti i rrushit i pakaramelizuar i përftuar nga dehidratimi i pjesshëm i mushtit të rrushit nëpërmjet njërës prej metodave të autorizuara, përveç ngrohjes direkte, në mënyrë që vlera e treguar nga refraktometri i përdorur në temperaturë 20°C të jetë jo më pak se 50,9%. Vlera e lejuar e fortësisë alkoolike aktuale e mushtit të përqendruar të rrushit është jo më shumë se 1% vol.;

20.14 "Mushti i rrushit i përqendruar i korrigjuar", me fortësi alkoolike efektive jo më shumë se 1% vol., është:

a) produkti i lëngshëm i pakaramelizuar, i cili:

i. përftohet nga dehidratimi i pjesshëm i mushtit të rrushit nëpërmjet ndonjërës prej metodave të autorizuara, ndryshe nga ngrohja direkte, në mënyrë që vlera e treguar nga refraktometri në temperaturë 20°C të jetë jo më pak se 61,7%;

ii. ka qenë objekt i përpunimit të autorizuar për deacidifikimin dhe eliminimin e përbërësve të ndryshëm nga sheqeri;

iii. ka karakteristikat e mëposhtme:

- pH me vlerë jo më të lartë se 5 në 25 *Brix*;
- dendësi optike në 425 nm për trashësi 1 cm jo më shumë se 0,100 në musht rrushi të përqendruar në 25 *Brix*;
- përmbajtje sakaroze të padiktueshme nga metoda e analizës që do të përcaktohet;
- tregues *Folin-Ciocalteu* me vlerë jo më të lartë se 6,00 në 25 *Brix*;
- aciditet total jo më shumë se 15 miliekuivalente për kilogram të sheqerit total;
- përmbajtje dyoksidi squfuri jo më shumë se 25 miligramë për kilogram të sheqerit total;
- përmbajtje totale kationesh jo më shumë se 8 miliekuivalent për kilogram të sheqerit total;
- përçueshmëri jo më shumë se 120 *micro-Siemens*/cm në 25 *Brix* dhe 20°C;
- përmbajtje hidroksimetilfurfurali jo më shumë se 25 miligramë për kilogram të sheqerit total;
- prani mezoinozitoli.

b) produkti i ngurtë i pakaramelizuar, i cili:

i. përftohet nga kristalizimi i mushtit të rrushit të lëngët, të përqendruar e të korrigjuar, pa përdorur tretës;

ii. ka qenë objekt i përpunimit të autorizuar për deacidifikimin dhe eliminimin e përbërësve të ndryshëm nga sheqeri;

iii. ka karakteristikat e mëposhtme pas tretjes në një solucion 25 *Brix*:

- pH me vlerë jo më të lartë se 7,5;
- dendësi optike në 425 nm për trashësi 1 cm jo më shumë se 0,100;
- përmbajtje sakaroze të padiktueshme nga metoda e analizës që do të përcaktohet;
- tregues *Folin-Ciocalteu* me vlerë jo më të lartë se 6,00;
- aciditet total jo më shumë se 15 miliekuivalente për kilogram të sheqerit total;
- përmbajtje dyoksidi squfuri jo më shumë se 10 miligramë për kilogram të sheqerit total;
- përmbajtje totale kationesh jo më shumë se 8 miliekuivalente për kilogram të sheqerit total;
- përçueshmëri jo më shumë se 120 *micro-Siemens*/cm në 20 °C;
- përmbajtje hidroksimetilfurfurali jo më shumë se 25 miligramë për kilogram të sheqerit total;
- prani mezoinozitoli."

20.15 "Vera nga rrushi i tharë" është produkti, që:

a) prodhohet pa pasurim nga rrushi i lënë nën diell ose në hije për dehidratim të pjesshëm;

b) ka fortësi alkoolike totale të paktën 16% vol. dhe fortësi alkoolike aktuale të paktën 9% vol.; dhe

c) ka fortësi alkoolike natyrale të paktën 16% vol. (ose 272 gramë sheqer/litër).

20.16 "Vera nga rrushi i tejpjekur" është produkti që:

a) prodhohet pa pasurim;

b) ka fortësi alkoolike efektive me më shumë se 15% vol.; dhe

c) ka fortësi alkoolike totale jo më pak se 15% vol. dhe fortësi alkoolike efektive jo më pak se 12% vol.

20.17 "Uthulla e verës" është uthulla që:

a) përftohet ekskluzivisht nga fermentimi acetik i verës; në kuptim të ligjit nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", alkooli etilik që përdoret për prodhimin e uthullës të kodit tarifor NK 2209 duhet të jetë i denatyruar me anë të shtimit të 1.50% të acidit *acetic glacial*; dhe

b) ka aciditet total jo më pak se 60 gramë për litër, të shprehur si acid acetik.

21. "Rregulla të përdorura nga prodhuesit e verës" janë rregulla të vendosura nga vetë prodhuesit në momentin e kërkesës për marrjen e termit tradicional;

22. "Ministria" është ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë;

23. "Ministri" është ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

Neni 3
Kategoritë e produkteve të rrushit për verë

1. Emrat e kategorive të produkteve të rrushit të listuara në pikën 13 të nenit 2 të këtij ligji janë emrat me të cilët shiten këto produkte sipas legjislacionit në fuqi për etiketimin e produkteve ushqimore dhe informimin e konsumatorit.

2. Përdorimi i termit "verë", përveç sa përcaktohet në nenin 2, pika 20, të këtij ligji, lejohet vetëm nëse:

a) shoqërohet me emrin e një frute në formën e një emri të përbërë për të tregtuar produktet e përftuara nga fermentimi i frutave të ndryshme nga rrushi; ose

b) është pjesë e një emri të përbërë.

3. Në zbatim të pikës 2 të këtij neni, me urdhër ministri përcaktohen kushtet për përdorimin e termit "verë".

KREU II
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Neni 4
Institucionet përgjegjëse për vreshtarinë dhe verën

1. Institucionet përgjegjëse për vreshtarinë dhe verën janë institucionet në varësi të ministrisë, që janë përgjegjëse, për:

a) transferimin e teknologjive bujqësore;

b) këshillimin bujqësor;

c) kontrollin e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë;

ç) mbajtjen e regjistrave etj.

2. Institucionet përgjegjëse sipas këtij ligji përmbushin detyra për:

a) krijimin, regjistrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e kadastrës së vreshtarisë;

b) mbledhjen e të dhënave në lidhje me prodhimin potencial në sektorin e verës;

c) verifikimin e të dhënave dhe kontrollin e kultivuesve, vjelësve, prodhuesve, përpunuesve, shitësve me pakicë, mbushësit e shisheve dhe tregtarët në lidhje me informacionin e përfshirë në regjistrin e vreshtit;

ç) autorizimin e përdorimit dhe mbledhjes së të dhënave në lidhje me varietetet e rrushit për verë që lejohen për kërkime shkencore dhe qëllime eksperimentale;

d) autorizimin për përdorimin e praktikave enologjike të paautorizuara;

dh) kryerjen e kontrolleve te vreshtarët në lidhje me varietetet e rrushit për verë të mbjella në parcela të regjistruara në regjistrin e vreshtave, siç përcaktohet në nenin 11 të këtij ligji, për përmbushjen e dispozitave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

3. Detyrat e institucioneve përgjegjëse, sipas fushave të përgjegjësisë, si dhe përfaqësuesit e tyre përcaktohen me urdhër ministri.

4. Ministria bën reflektimet në aktet ligjore përkatëse të institucioneve të varësisë sipas fushës përkatëse.

Neni 5
Institucioni përgjegjës për kontrollet

1. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë është institucioni

përgjegjës i kontrollit në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit lidhur me produktet e verës, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për ushqimin, si dhe për:

a) kryerjen e kontrollit të dokumenteve shoqëruese ose dokumenteve të tjera, siç përcaktohet në nenin 38 të këtij ligji, gjatë transportit të produkteve të verës;

b) kryerjen e kontrollit të regjistrave të hyrje-daljeve;

c) kryerjen e kontrollit të instalimeve të përdorura për prodhimin dhe ruajtjen e produkteve të verës;

ç) kryerjen e analizave zyrtare në sektorin e verës;

d) marrjen e mostrave të produkteve të verës, substancave ose produkteve që mund të përdoren për përgatitjen e këtyre produkteve;

dh) certifikimin dhe kontrollin e produkteve të sektorit të verës:

i. me TGJM-në dhe EOM-në, sipas legjislacionit për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore;

ii. pa TGJM-në/EOM-në, përcaktuar në etiketë, viti i vjeljes dhe emri i varietetit të rrushit, referuar pikave 1 dhe 2 të nenit 32 të këtij ligji.

e) kontrollin e tërheqjes së nënprodukteve sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji.

2. Kontrollet e përcaktuara në shkronjat "a" - "e" të pikës 1 të këtij neni kryhen sipas parimeve, procedurave dhe në mënyrën e përcaktuar në legjislacionin për ushqimin.

Neni 6
Certifikata e origjinës

Institucioni përgjegjës për lëshimin e certifikatës së origjinës së produkteve të sektorit të verës, të destinuara për eksport, është Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 7
Ministria

1. Ministria është institucion përgjegjës për:

a) vlerësimin e specifikimeve të produkteve të verës me TGJM dhe EOM, referuar legjislacionit në fuqi për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore;

b) përcaktimin me urdhër ministri të laboratorëve të akredituar për kryerjen e analizave fizike dhe kimike të produkteve të sektorit të verës.

2. Rregullat për laboratorët e akredituar, qëllimin e analizës, metodat e marrjes së mostrës, analizat fiziko-kimike, cilësinë e produkteve të rrushit për verë, përcaktohen me urdhër ministri, referuar edhe legjislacionit në fushën e akreditimit.

3. Ministri miraton me urdhër laboratorët e akredituar të cilët kryejnë analizat.

Neni 8
Këshilli Kombëtar i Vitivinikulturës

1. Pranë ministrisë krijohet dhe funksionon Këshilli Kombëtar i Vitivinikulturës, një organ konsultativ, i cili drejtohet nga ministri.

2. Këshilli Kombëtar i Vitivinikulturës përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, me eksperiencë mbi 5 vjet në këtë fushë, si më poshtë:

a) 2 përfaqësues të ministrisë, përgjegjës për politikat agrare;

b) 1 përfaqësues nga ministria që mbulon çështjet ekonomike;

c) 1 përfaqësues nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë;

ç) 1 përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, me profil "Vreshtari –Enologji";

d) 1 përfaqësues nga Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

dh) 2 përfaqësues nga Shoqatat e Prodhuesve të Verës;

e) 2 përfaqësues nga shoqatat/kooperativat/ bashkimet e vreshtarëve;

ë) 1 përfaqësues nga Shoqata Shqiptare e Somelierisë.

3. Rregullat e funksionimit dhe detyrat e Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9
Funksionet e Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës

Këshilli Kombëtar i Vitivinikulturës kryen këto funksione:

1. Këshillon, informon dhe rregullon, kur kërkohen, ndryshime ligjore ose rregullatore që

ndikojnë drejtpërdrejt në vitivinikulturë, si dhe formulon propozimet në këtë fushë.

2. Përpilon rekomandime për planet e veprimit strategjik.

3. Shqyrton masat sektoriale të lidhura me sektorin e vreshtarisë dhe verës.

4. Propozon veprimet e nevojshme për promovimin e vitivinikulturës, duke kryer studimet e nevojshme për këtë qëllim.

5. Çdo funksion tjetër që mund t'i delegohet nga aktet ligjore dhe nënligjore.

6. Këshilli përcjell të gjitha propozimet tek ministri.

KREU III
MEKANIZMAT E SEKTORIT TË VERËS

Neni 10
Varietet e rrushit për verë

1. Vetëm varietet e rrushit për verë që plotësojnë kushtet e mëposhtme mund të mbillen, rimbillen apo shartohen në Republikën e Shqipërisë, me qëllim prodhimin e produkteve të verës:

a) varietetet që i përkasin species *Vitis vinifera* ose janë përftuar nga shartimi ndërmjet varieteteve të species *Vitis Vinifera* dhe specieve të tjera të gjinisë *Vitis*;

b) varietetet që nuk i përkasin: *Noah, Othello, Isabelle, Jacquez, Clinton* dhe *Herbemont.*

2. Përjashtimisht vetëm për kërkime studimore dhe shkencore dhe për qëllime eksperimentale lejohet mbjellja, rimbjellja ose shartimi i vreshtave me varietete që nuk plotësojnë kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

3. Me urdhër të ministrit bëhet klasifikimi i varieteteve të rrushit për verë që përdoren për prodhimin e produkteve të verës, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të këtij neni, dhe duke marrë në konsideratë emrat e varieteteve të rrushit në regjistrin e vreshtarisë e katalogun kombëtar të varieteteve.

4. Orientimet/drejtimet për kërkimet shkencore dhe qëllime eksperimentale të përdorimit të varieteteve të rrushit për verë përcaktohen me urdhër ministri, me propozim të Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës.

5. Vreshtat e mbjella me varietete, që nuk plotësojnë kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ose dispozitat në rastin e nxjerrjes së urdhrit të ministrit, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të shkulen. Nuk do të ketë asnjë detyrim për të shkulur vreshta të tilla, ku prodhimi përkatës është menduar ekskluzivisht për konsum nga familja e prodhuesit të verës.

6. Përcaktimi i zonave të prodhimit të rrushit për verë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit, bazuar në të dhënat e studimit për "Zonat e kultivimit të vreshtave për verë", të miratuar prej tij.

Neni 11
Regjistri i vreshtave

1. Regjistri i vreshtave krijohet nga institucioni përgjegjës për transferimin e teknologjive bujqësore dhe përmban informacion në lidhje me:

a) kadastrën e vreshtave;

b) të dhëna për prodhimin potencial në sektorin e verës;

c) identifikimin e vreshtave heroike.

2. Vreshtarët, vjelësit, prodhuesit, përpunuesit dhe mbushësit e shisheve duhet të regjistrohen në regjistrin e vreshtave.

3. Futja në regjistrin e vreshtave bëhet në bazë të kërkesës për regjistrim që plotësohet një herë nga:

a) vreshtarët dhe duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

i. identitetin e aplikantit;

ii. vendndodhjen e secilës parcelë vreshti;

iii. sipërfaqen e çdo parcele vreshti duke treguar:

- sipërfaqen për çdo varietet vreshti;
- ngjyrën e rrushit;
- vitin e mbjelljes të çdo varieteti;
- në rastin e varieteteve të prodhimit të verërave me TGJM-në, EOM-në, ose verërave pa TGJM-në/EOM-në, përdorimi në etiketë i emrit të varietetit me informacion të ndarë rreth tij.

b) vjelësit dhe prodhuesit dhe duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

i. identitetin e aplikantit;

ii. vendndodhjen ku kryhet përpunimi i verës apo mushtit.

c) përpunuesit dhe duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

i. identitetin e aplikantit;

ii. vendndodhjen ku kryhet përpunimi i verës.

ç) mbushësit e shisheve dhe duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

i. identitetin e aplikantit;

ii. vendndodhjen ku kryhet mbushja e shisheve.

4. Forma e kërkesës për regjistrim miratohet nga ministri.

5. Vreshtarët, vjelësit, prodhuesit, përpunuesit dhe mbushësit e shisheve të regjistruar në regjistrin e vreshtave duhet të raportojnë pranë institucionit përgjegjës çdo ndryshim të të dhënave, përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

6. Raportimi i ndryshimeve në të dhënat ose heqja nga regjistri i vreshtave, sipas pikës 5 të këtij neni, bëhet sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit.

7. Verifikimi i të dhënave të regjistrit të vreshtave bëhet nga institucioni përgjegjës për transferimin e teknologjive bujqësore të paktën çdo 5 (pesë) vjet.

8. Rregullat për krijimin, përmbajtjen, funksionimin dhe administrimin e regjistrit të vreshtave dhe kriteret për regjistrimin e vreshtit heroik miratohen nga ministri.

Neni 12
Potenciali i prodhimit

1. Vjelësit dhe prodhuesit e regjistruar në regjistrin e vreshtave brenda datës 15 janar të çdo viti duhet të dorëzojnë pranë institucionit përgjegjës për transferimin e teknologjive bujqësore deklaratën e prodhimit.

2. Prodhuesit, përpunuesit dhe mbushësit e shisheve, të regjistruar në regjistrin e vreshtave, brenda datës 10 shtator të çdo viti duhet të dorëzojnë pranë institucionit përgjegjës për transferimin e teknologjive bujqësore gjendjen stok të mushtit dhe verës deri më 31 korrik të vitit të mëparshëm të verës.

3. Vjelësit e regjistruar në regjistrin e verës brenda datës 15 janar të çdo viti duhet të dorëzojnë pranë institucionit përgjegjës për transferimin e teknologjive bujqësore deklaratën e vjeljes për vitin e verës kur është kryer vjelja.

4. Vjelësit që mbledhin të vjelat e rrushit nga një sipërfaqe e mbjellë me vresht më e vogël se 0,5 ha përjashtohen nga detyrimi për deklarimin sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 3 të këtij neni.

5. Subjektet e regjistruara në regjistrin e vreshtave, përcaktuar në pikat 1-3 të këtij neni, duhet të ruajnë të dhënat për të paktën 5 (pesë) vjet.

6. Rregullat për mbajtjen e deklaratave të përcaktuara në pikat 1-3 të këtij neni, formularët që duhet të plotësohen nga operatorët dhe mënyra e grumbullimit të informacionit për prodhimin potencial përcaktohen me rregullore të miratuar me urdhër të ministrit.

Neni 13
Praktikat enologjike

1. Vetëm praktikat enologjike të autorizuara në përputhje me këtë ligj lejohen për prodhimin dhe ruajtjen e produkteve të rrushit, përcaktuar sipas nenit 2, pika 20, të këtij ligji.

Përcaktimet e kësaj pike nuk zbatohen, për:

a) lëng rrushi dhe lëng rrushi të përqendruar; dhe

b) musht rrushi dhe musht rrushi i përqendruar, që kanë si qëllim përgatitjen e lëngut të rrushit.

2. Praktikat enologjike të autorizuara përdoren vetëm për të siguruar kryerjen si duhet të vinifikimit, ruajtjen e përshtatshme ose përmirësimin e duhur të produktit.

3. Produktet e listuara në nenin 3 të këtij ligji, nuk do të tregtohen në qoftë se u janë nënshtruar praktikave enologjike të paautorizuara.

4. Praktikat enologjike të autorizuara dhe metodat e analizave për analizimin e verërave janë metoda dhe analiza të rekomanduara e të publikuara, referuar pikës 7 të këtij neni, si dhe rezultate eksperimentale të përdorura ende si praktika të paautorizuara enologjike.

5. Produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit, të cilat janë të patregtueshme në përputhje me pikën 1 të këtij neni do të asgjësohen.

6. Në ndryshim nga përcaktimi në pikën 5 të këtij neni, institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, mund të autorizojë përdorimin e disave prej këtyre produkteve, karakteristikat e të cilave duhet t'i përcaktojnë distiluesit apo fabrikat e uthullës ose për qëllime industriale, me kusht që ky autorizim të mos nxisë prodhimin e produkteve të rrushit për verë nëpërmjet praktikave të paautorizuara enologjike.

7. Rregulla të detajuara lidhur me praktikat enologjike, protokollet dhe metodat e analizave për produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare të prodhimit të verës të

Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës, OIV, veçanërisht pasurimi, acidifikimi dhe deacidifikimi, si dhe kufizimet që aplikohen do të përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 14
Kufizime për praktikat enologjike

1. Të gjitha praktikat e autorizuara enologjike të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji duhet të përjashtojnë:

a) shtimin e ujit, përveç kur është e nevojshme, për shkak të një domosdoshmërie specifike teknike;

b) shtimin e alkoolit, përveç praktikave që lidhen me përftimin e mushtit të rrushit të freskët në fermentim të ndaluar nga shtesa e alkoolit, verës së fortifikuar likeroze, verës së gazuar shkumbëzuese, verës pjesërisht të gazuar shkumëzuese.

2. Vera e fortifikuar për distilim të përdoret vetëm për distilim.

3. Mushti i rrushit të freskët në të cilin fermentimi është ndaluar nga shtimi i alkoolit, të përdoret vetëm gjatë fazës së përgatitjes së produkteve që nuk përfshihen në kodet NK 2204 10, 2204 21 dhe 2204 29.

4. Lëngu i rrushit dhe lëngu i rrushit të përqendruar:

a) nuk do të përdoren për prodhimin e verës ose nuk do t'i shtohen verës;

b) nuk do t'i nënshtrohen fermentimit alkoolik.

5. Rrushi i freskët, mushti i rrushit, mushti i rrushit në fermentim, mushti i rrushit të përqendruar, mushti i rrushit të përqendruar e të korrigjuar, mushti i rrushit në fermentim të ndaluar nga shtimi i alkoolit, lëngu i rrushit, lëngu i rrushit të përqendruar dhe verës ose përzierje të këtyre produkteve që kanë origjinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk lejohet të përdoren për të prodhuar produktet e përcaktuara në nenin 2, pika 20, të këtij ligji, ose t'u shtohen këtyre produkteve.

6. Kupazhimi i një vere që e ka origjinën nga një vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me një verë shqiptare dhe kupazhimi ndërmjet verërave që kanë origjinë nga vende jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është i ndaluar.

Neni 15
Kufizime për nënproduktet

1. Ndalohet presimi i thellë i rrushit në mënyrë të tillë që sasia e alkoolit që përmbajnë bërsitë dhe llumrat pas presimit të rrushit nuk duhet të jetë më e ulët se 5% në raport me vëllimin e alkoolit që përmban vera e prodhuar dhe jo më e ulët se 0,425% të fortësisë alkoolike natyrale sipas vëllimit.

2. Me përjashtim të alkoolit, likereve dhe *Piquette*-it, vera ose çdo pije tjetër për konsum njerëzor direkt nuk duhet të prodhohet nga llum vere apo bërsi rrushi.

3. Ndalohet shtypja e llumit të verës dhe rifermentimi i bërsive të rrushit për qëllime të ndryshme nga distilimi ose prodhimi i *Piquette*-it.

4. *Piquette*-i do të përdoret vetëm për distilim ose për konsum familjar nga prodhues të verës.

5. Nën mbikëqyrjen e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, prodhuesit duhet të tërheqin nënproduktet jo më vonë se në fund të vitit të verës, kur këto nënprodukte janë përftuar.

6. Në ndryshim nga pika 5 e këtij neni, prodhuesit, të cilët gjatë vitit përkatës të verës nuk prodhojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) hektolitra verë ose musht në kantinat e tyre, përjashtohen nga dispozitat e ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe nuk u kërkohet tërheqja e nënprodukteve të tyre me mbikëqyrjen e Inspektoratit të Kontrollit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë.

7. Rregulla shtesë për tërheqjen e nënprodukteve, duke marrë në konsideratë veçanërisht mbrojtjen e mjedisit, mund të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 16
Regjistri i hyrjeve dhe daljeve

1. Personat fizikë ose juridikë ose një grupim i tyre, të cilët mbajnë produkte vere në ushtrimin e tregtisë së tyre, në veçanti prodhuesit, mbushësit e shisheve, përpunuesit dhe tregtarët, mbajnë regjistrat e hyrjeve dhe daljeve lidhur me produktet e tyre.

2. Në ndryshim nga pika 1 e këtij neni, dhe me kusht që hyrjet, tërheqjet dhe gjendja stok mund të kontrollohen në çdo kohë mbi bazë të dokumentacionit tregtar që përdoret për llogaritë financiare, regjistrat e hyrjeve dhe daljeve nuk është nevoja të mbahen nga:

a) operatorët, të cilët mbajnë gjendje stok ose ofrojnë për shitje vetëm produkte të verës në kontejnerë të etiketuar me një vëllim nominal prej 10 litrash ose më pak, të pajisur me një pajisje mbyllëse jo të ripërdorshme;

b) operatorët që shesin pije për konsum vetëm në vendndodhjen e tyre;

c) shitësit me pakicë.

3. Rregulla të detajuara për regjistrat e hyrjeve dhe daljeve përcaktohen me urdhër ministri, duke marrë në konsideratë mundësinë e kontrollit dhe standardeve ndërkombëtare për produktet e sektorit të verës.

KREU IV
EMËRTIMI I ORIGJINËS, TREGUESVE GJEOGRAFIKË DHE TERMAT TRADICIONALË

Neni 17
Kërkesat

1. Rregullat për emërtimet e origjinës, treguesit gjeografikë dhe termat tradicionalë të përcaktuar në këtë kapitull aplikohen për produktet e listuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1; 20.3–20.6; 20.8; 20.9; 20.11; 20.15 dhe 20.16, të këtij ligji.

2. Rregullat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përdoren, për:

a) mbrojtjen e interesave legjitime të prodhuesve dhe konsumatorëve;

b) garantimin e konkurrencës së drejtë me qëllim mirëfunksionimin e tregut të brendshëm; dhe

c) promovimin e prodhimit të produkteve cilësore të përcaktuara në këtë kapitull.

Neni 18
Organet përgjegjëse

1. Ministria është autoriteti kompetent për vlerësimin e specifikimeve të verërave, për:

a) emërtimet e origjinës (në vijim "EO"); dhe

b) treguesit gjeografikë (në vijim "TGJ").

2. Në ministri krijohet dhe funksionon Komisioni i Verës për:

a) ekzaminimin në substancë të specifikimeve të verërave me EO-në dhe TGJ-në;

b) vlerësimin e kërkesave për verërat me term tradicional;

c) vlerësimin e ndryshimeve për specifikimet e produktit me term tradicional;

ç) kundërshtimet e kërkesave për regjistrimin e verërave me term tradicional dhe kundërshtimet për ndryshimin e specifikimeve të verërave me EOM-në dhe TGJM-në;

d) regjistrimin e emërtimeve me term tradicional.

3. Struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në ministri (në vijim "struktura përgjegjëse") kryen:

a) marrjen/pranimin e kërkesave nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për vlerësimin e përputhshmërisë me specifikimet për regjistrimin si përcaktime EO dhe TGJ të verërave;

b) marrjen/pranimin e kërkesave nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për vlerësimin e kundërshtimeve të kërkesave për EO-në ose TGJ-në;

c) marrjen (pranimin) e kërkesës nga grupet e prodhuesve për termin tradicional;

ç) mbajtjen e regjistrit për termin tradicional;

d) përcjelljen e dokumentacionit Komisionit të Verës;

dh) rolin e sekretariatit teknik për Komisionin e Verës;

e) detyra të tjera të përcaktuara në ligj ose akte nënligjore.

Neni 19
Komisioni i Verës

1. Komisioni i Verës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, si më poshtë:

a) dy përfaqësues nga ministria, ekspertë të drejtorisë/strukturës përgjegjëse që merret me sektorin e vreshtarisë dhe verës;

b) pesë ekspertë nga fusha akademike, institucionet kërkimore-shkencore apo të pavarura, me njohuri të gjera për çështjet që lidhen me TGJ-të dhe EO-të, të verërave me profesione, si: enolog, agronomi dhe vitikulturë; inxhinier kimist; somelier profesionist; degustator, me një eksperiencë prej të paktën 15-vjeçare.

2. Anëtarët e komisionit, përfshirë edhe kryetarin, emërohen e lirohen me urdhër të ministrit dhe zgjidhen bazuar në arsimin, profesionin dhe eksperiencën, e cila duhet të jetë të paktën 15-vjeçare në profesion, me punime shkencore në fushën përkatëse.

3. Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë zgjidhet kryetar i komisionit me urdhër të ministrit.

4. Pagesa e komisionit bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

5. Funksionimi, kohëzgjatja, organizimi dhe detyrat e komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 20
Dorëzimi i kërkesave për TGJ-në dhe EO-në për verën dhe vlerësimi nga Komisioni i Verës

1. Struktura përgjegjëse pas marrjes së kërkesës për vlerësim për regjistrim të një vere me TGJ-në ose EO-në nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e dërgon atë te Komisioni i Verës brenda 5 (pesë) ditëve pune.

2. Komisioni i Verës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, sipas nenit 31 të këtij ligji, vlerëson dhe vendos nëse ato përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 176 të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, si dhe referuar kompetencave të specifikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 182/c të tij. Vendimi i komisionit dërgohet te ministri për miratim dhe më pas përcillet te Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

3. Në rast të paraqitjes së një kundërshtimi të kërkesës për regjistrim të një vere me TGJ ose EO nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Komisioni i Verës brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve pune shqyrton dhe merr vendim për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 176 të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, duke iu referuar kërkesave të përcaktuara në pikën 7 të nenit 182/ç të tij. Vendimi i Komisionit dërgohet te ministri për miratim dhe më pas përcillet te Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Neni 21
Mbrojtja e termit tradicional

1. Termi tradicional i mbrojtur mund të përdoret vetëm për një produkt të prodhuar, në përputhje me përkufizimin e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 12 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Termat tradicionalë mbrohen nga përdorimi i paligjshëm.

3. Termat tradicionalë mbrohen vetëm në gjuhën dhe për kategoritë e produkteve të përftuara nga përpunimi i rrushit për verë të pretenduara në kërkesë nga:

a) çdo keqpërdorim i termit të mbrojtur, duke përfshirë rastet kur shoqërohet me shprehje të tilla si "lloji", "tipi", "metoda", "siç prodhohet në", "imitim", "aromë", "si" apo të ngjashme;

b) çdo tregues tjetër i rremë ose çorientues, për sa u përket natyrës, karakteristikave ose cilësive thelbësore të produktit të vendosura në paketimin e jashtëm ose të brendshëm, në materialet reklamuese ose dokumentet përkatëse;

c) çdo praktikë tjetër që ka gjasa ta çorientojë konsumatorin, veçanërisht në krijimin e përshtypjes se vera kualifikohet për termin e mbrojtur tradicional.

4. Termat tradicionalë nuk kthehen në terma të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë.

5. Termat tradicionalë quhen të mbrojtur në territorin e Republikës së Shqipërisë me marrjen e vendimit për regjistrim dhe regjistrimin në regjistër, i cili është publik.

6. Forma dhe përmbajtja e regjistrit miratohet me udhëzim ministri.

Neni 22
Gjuha dhe germëzimi për termat tradicionalë

Një term tradicional regjistrohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën e përdorur në tregtim për këtë term dhe sipas germëzimit origjinal e shkrimit origjinal.

Neni 23
Aplikantët

Çdo organizatë prodhuese ose shoqatë e organizatave prodhuese që ka miratuar të njëjtat rregulla, që vepron në zonën e një ose më shumë

verërave me emërtim origjine ose tregues gjeografikë, që përfshin në anëtarësinë e saj të paktën dy të tretat e prodhuesve të vendosur në atë zonë dhe llogarit të paktën dy të tretat e prodhimit të asaj zone (në vijim "organizata profesionale përfaqësuese") mund të paraqesë një kërkesë për mbrojtje të një termi tradicional vetëm për produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë të prodhuara prej saj.

Neni 24
Pranueshmëria e kërkesës

1. Kërkesat për mbrojtje të termit tradicional për EOM-në ose TGJM-në specifike dorëzohen në strukturën përgjegjëse në ministri, e cila kryen funksionet e sekretariatit të Komisionit të Verës.

2. Kërkesat për mbrojtje të termit tradicional konsiderohen të pranueshme kur ato paraqiten në përputhje me nenin 23 të këtij ligji dhe janë plotësuar sipas parashikimeve të akteve ligjore e nënligjore.

3. Një kërkesë konsiderohet e plotësuar kur përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin që duhet të mbrohet si një term tradicional;

b) llojin e termit tradicional, pavarësisht nëse ai përfshihet në shkronjën "d" të pikës 12 të nenit 2 të këtij ligji;

c) gjuhën në të cilën shprehet emri që duhet të mbrohet si term tradicional;

ç) kategorinë ose kategoritë e produkteve të rrushit për verë;

d) një përmbledhje të përcaktimeve dhe kushteve të përdorura;

dh) përcaktimet e emërtimit të origjinës të mbrojtur ose treguesve gjeografikë të mbrojtur.

4. Kërkesa duhet të shoqërohet me një kopje të rregullave të përdorura nga prodhuesit e verës, që rregullojnë përdorimin e termit tradicional në fjalë.

5. Në qoftë se kërkesa nuk plotësohet në mënyrën e duhur ose dokumentet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni nuk paraqiten së bashku me kërkesën, kërkesa nuk pranohet.

6. Modeli i kërkesës dhe i kundërshtimit për termat tradicionalë përcaktohet me urdhër ministri.

7. Tarifat e shërbimeve për regjistrimin e kundërshtimin e termave tradicionalë paguhen nga kërkuesi dhe përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit e të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 25
Kushtet e vlefshmërisë

1. Një kërkesë për mbrojtjen e termit tradicional konsiderohet e vlefshme në rast se emri për të cilin kërkohet mbrojtje:

a) plotëson kërkesat e termit tradicional;

b) konsiston ekskluzivisht, ose:

i. në një emër të përdorur tradicionalisht për të paktën 5 (pesë) vjet në gjuhën shqipe ose për të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vjet në gjuhën e përdorur në tregti në një pjesë të madhe të territorit të Republikës së Shqipërisë për të dalluar kategori specifike të produkteve të rrushit për verë; ose

ii. në një emër me famë i përdorur në tregti në territorin e Republikës së Shqipërisë për të dalluar kategori specifike të produkteve të rrushit për verë.

c) nuk është bërë i përgjithshëm; dhe

ç) u nënshtrohet kushteve të përdorimit siç parashikohet nga rregullat e zbatueshme për prodhuesit e verës, përfshirë ato që burojnë nga organizatat profesionale përfaqësuese.

2. Për qëllime të shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, një emër që është bërë "i përgjithshëm" do të thotë emri, i cili, megjithëse lidhet me një metodë specifike të prodhimit ose metodën e vjetrimit, ose cilësinë, ngjyrën, llojin e vendit, ose një ngjarje të veçantë të lidhur me historinë e një produkti të rrushit për verë, është bërë emri i zakonshëm i këtij produkti në Republikën e Shqipërisë.

Neni 26
Shqyrtimi nga Komisioni i Verës

Shqyrtimi i kërkesave për termin tradicional kryhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8/2019 "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore".

Neni 27
Pranueshmëria dhe arsyet e kundërshtimit

Një kundërshtim për mbrojtjen e një termi tradicional është i pranueshëm kur:

1. Paraqitet nga çdo person fizik apo juridik që ka një interes të legjitimuar;

2. Vërteton/tregon/demonstron që kërkesa për mbrojtje është e papajtueshme me rregullat për termin tradicional, sepse nuk është në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, ose sepse regjistrimi i emrit të propozuar do të binte ndesh me nenet 28 ose 29 të këtij ligji.

Neni 28
Lidhja me markat tregtare

1. Regjistrimi i një marke tregtare që përmban ose konsiston në një term tradicional, i cili nuk respekton përkufizimin dhe kushtet e përdorimit të atij termi tradicional dhe që ka të bëjë me një kategori të produkteve të rrushit për verë, përcaktuar në nenin 2, pika 20, të këtij ligji:

a) refuzohet në rast se kërkesa për regjistrimin e markës tregtare është paraqitur pas datës së paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e termit tradicional dhe termi tradicional mbrohet më pas;

b) bëhet e pavlefshme.

2. Një emër nuk mbrohet si term tradicional kur për arsye të famës së një marke tregtare, një mbrojtje e tillë mund të keqinformojë konsumatorin për identitetin e vërtetë, natyrën, karakteristikën ose cilësinë e produktit të rrushit për verë.

3. Përjashtimisht parashikimeve në pikën 2 të këtij neni, një markë tregtare e përmendur në pikën 1 të këtij neni për të cilën është kërkuar, regjistruar ose krijuar me përdorim me mirëbesim përpara datës së mbrojtjes së termit tradicional, mund të vazhdojë të përdoret dhe rinovohet pavarësisht mbrojtjes së një termi tradicional, me kusht që të mos ketë arsye për pavlefshmërinë ose revokimin e markës tregtare. Në raste të tilla përdorimi i termit tradicional lejohet së bashku me markat tregtare përkatëse.

Neni 29
Homonimet

1. Një term për të cilin është paraqitur një kërkesë për mbrojtje dhe që është tërësisht apo pjesërisht i njëjtë me një term të mbrojtur sipas ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, do të regjistrohet duke marrë parasysh përdorimin lokal e tradicional dhe rrezikun e konfuzionit.

2. Një term homonim, i cili keqinformon konsumatorët për natyrën, cilësinë ose origjinën e vërtetë të produkteve të rrushit për verë nuk do të regjistrohet edhe nëse termi është i saktë.

3. Një term homonim i regjistruar mund të përdoret vetëm nëse ekziston një dallim i mjaftueshëm në praktikë midis homonimit të regjistruar më vonë dhe termit tashmë në regjistër, duke marrë parasysh nevojën për të trajtuar prodhuesit në mënyrë të drejtë dhe nevojën për të shmangur keqinformimin e konsumatorit.

KREU V
ETIKETIMI DHE PARAQITJA E INFORMACIONIT PËR KONSUMATORIN

Neni 30
Zbatueshmëria e rregullave horizontale

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, etiketimi dhe prezantimi i produkteve të sektorit të verës bëhet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për etiketimin dhe informimin e konsumatorit.

Neni 31
Informacione të detyrueshme

1. Etiketimi dhe paraqitja e produkteve të përcaktuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 20.11; 20.13; 20.15 dhe 20.16, të këtij ligji, që tregtohen brenda vendit ose eksportohen, përmban informacione të detyrueshme të përcaktuara si më poshtë:

a) emërtimin e kategorisë së produktit të rrushit për verë në përputhje me nenin 2 të këtij ligji. Për kategoritë e produkteve të rrushit të përcaktuara në nenin 2, pika 20, nënpika 20.1 dhe nënpikat 20.4 deri në 20.9, kur produkte të tilla i janë nënshtruar një trajtimi të dealkoolizimit, emërtimi i kategorisë do të shoqërohet nga:

i. termi "i dealkoolizuar" nëse fortësia alkoolike aktuale e produktit nuk është më shumë se 0,5 % në vëllim; ose

ii. termi "pjesërisht i dealkoolizuar" nëse fortësia alkoolike aktuale e produktit është mbi 0,5% në vëllim dhe është nën fortësinë alkoolike aktuale minimale të kategorisë përpara dealkoolizimit.

b) për verërat me emërtim origjine, termin "emërtim origjine i mbrojtur" dhe emrin e emërtimit të origjinës së mbrojtur;

c) për verërat me tregues gjeografik, termin "tregues gjeografik i mbrojtur" dhe emrin e treguesit gjeografik të mbrojtur;

ç) fortësinë alkoolike aktuale sipas vëllimit;

d) treguesin e prejardhjes;

dh) emrin e mbushësit ose në rastin e verës së gazuar shkumbëzuese, verës së gazifikuar shkumbëzuese, verës së gazuar shkumbëzuese cilësore ose verës së gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike, emrin e prodhuesit ose të shitësit;

e) emrin e importuesit në rastin e verërave të importuara; dhe

ë) në rastin e verës së gazuar shkumbëzuese, verës së gazifikuar shkumbëzuese, verës së gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike, treguesin e përmbajtjes së sheqerit;

f) tregues të substancave apo produkteve specifike që shkaktojnë alergji ose intolerancë, të përcaktuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për etiketimin dhe informimin e konsumatorit.

2. Në ndryshim nga pika 1 e këtij neni:

a) shkronja "a", referenca për kategorinë e produktit të vreshtit mund të përjashtohet për verërat etiketa e të cilave përfshin emrin e emërtimit të origjinës së mbrojtur ose të treguesit gjeografik të mbrojtur;

b) shkronjat "b" dhe "c", referenca për termat "emërtim origjine i mbrojtur" ose "tregues gjeografik i mbrojtur" mund të përjashtohet në rrethana të jashtëzakonshme e të justifikuara, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, për të garantuar përputhshmërinë me praktikat ekzistuese të etiketimit.

Neni 32
Informacione jo të detyrueshme

Etiketimi dhe informacioni i përcjellë për konsumatorët në etiketën e produkteve të përcaktuara në nenin 2, pika 20, veçanërisht nënpikat 20.1 deri në 20.11; 20.13; 20.15 dhe 20.16, të këtij ligji, mund të përmbajnë të dhëna jo të detyrueshme si më poshtë:

1. Vitin e vjeljes;

2. Emrin e një apo më shumë varieteteve të rrushit për verë;

3. Në rastin e produkteve të tjera, të ndryshme nga produktet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 31 të këtij ligji, tregohet përmbajtja e sheqerit;

4. Për verërat me EOM-në ose TGJM-në termat tradicionalë;

5. Simbolin që tregon emërtimin e origjinës së mbrojtur ose treguesin gjeografik të mbrojtur;

6. Termat që u referohen metodave të caktuara të prodhimit;

7. Për verërat me emërtim origjine të mbrojtur ose tregues gjeografik të mbrojtur, emrin e një tjetër njësie gjeografike më të vogël ose më të madhe se zona e emërtimit të origjinës ose e treguesit gjeografik.

Neni 33
Gjuhët

1. Informacionet e detyrueshme dhe jo të detyrueshme të përcaktuara në nenet 31 e 32 të këtij ligji, kur shprehen me fjalë, paraqiten në gjuhën shqipe.

2. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, produktet e përcaktuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 20.11; 20.13; 20.15 dhe 20.16, të këtij ligji, që janë të destinuara për eksport, përveçse në gjuhën shqipe, mund të paraqiten edhe në një ose disa gjuhë të tjera.

Neni 34
Ambalazhimi i produkteve të rrushit për verë

1. Gjatë prodhimit dhe transportit, produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë duhet të mbahen në kontejnerë, të cilët ruajnë karakteristikat e tyre.

2. Produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë të përcaktuara në nenin 2, pika 20, të këtij ligji, shiten të ambalazhuara në sasi të shprehur në mililitra nga 100 deri në 5000 si më poshtë:

a) produktet në nënpikat 20.1; 20.2; 20.15; 20.16 shiten vetëm në këto 10 (dhjetë) sasi nominale të shprehura në mililitra: 100 - 187 - 250 - 375 - 500 - 750 - 1 000 - 1 500 - 3000 - 5000;

b) produktet në nënpikën 20.3 shiten vetëm në këto 7 (shtatë) sasi nominale të shprehura në mililitra: 100 - 200 - 375 – 500 - 750 - 1 000 - 1500;

c) produktet në nënpikat 20.4; 20.5; 20.6; 20.7; 20.8; 20.9 shiten vetëm në këto 7 (shtatë) sasi

nominale të shprehura në mililitra: 125 - 200 - 375 - 750 - 1 500 – 3000 - 5000.

3. Lejohet mbushja me ambalazhe konvencionale më specifike të vëllimeve më të mëdha me kërkesë të prodhuesit dhe mbushësit, me miratimin e institucionit përgjegjës të kontrollit të ushqimit, i cili përcakton vëllimin dhe kohën e lejuar të përdorimit.

Neni 35
Rregullat shtesë për etiketimin

Rregullat shtesë specifike, që kanë të bëjnë me informacione të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të sektorit të verës, përcaktohen me urdhër ministri.

Neni 36
Procedura e certifikimit për produktet pa EOM-në dhe TGJM-në

1. Përdorimi i hollësive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 32 për verërat pa EOM-në ose TGJM-në bëhet në rast se këto verëra certifikohen për të garantuar vërtetësinë e informacionit përkatës.

2. Ministri me urdhër përcakton:

a) procedurat për certifikimin, miratimin dhe verifikimin për përdorimin e vitit të vjeljes ose emrin e një apo më shumë varieteteve, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 32, në etiketimin e verërave pa EOM-në dhe TGJM-në;

b) listën e varieteteve të rrushit të verës ose sinonimet e saj, që mund të vihen në etiketën e verërave pa EOM-në ose TGJM-në, për të garantuar që emra të tillë nuk janë duke manipuluar konsumatorët për origjinën e vërtetë të verës, që varieteti i rrushit të verës formon një pjesë integrale të një EOM-je ose TGJM-je, mbi baza të kritereve mosdiskriminuese dhe objektive për të garantuar konkurrencën e ndershme.

3. Certifikimi i produkteve pa EOM-në dhe TGJM-në kryhet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë sipas nënndarjes "ii" të shkronjës "dh" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, ose nga Trupa Certifikuese, të miratuara sipas ligjit nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore".

KREU VI
QARKULLIMI I PRODUKTEVE TË SEKTORIT TË VERËS

Neni 37
Kërkesat për tregtim për verërat e vendit

1. Vetëm produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë të përftuara nga varietete rrushi të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, që prodhohen në parcela vreshti të ndodhura në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e vreshtarisë sipas nenit 11 të këtij ligji dhe të etiketuara në përputhje me këtë ligj mund të tregtohen.

2. Produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë pa EOM-në ose TGJM-në me vit vere ose emër të një apo më shumë varieteteve të rrushit për verë të vendosur në etiketë mund të tregtohen vetëm në rast se këto produkte të rrushit për verë plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe janë certifikuar sipas rregullave të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji.

3. Produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë, që përdorin në etiketë termat EOM, TGJM ose termat tradicionalë, mund të shiten vetëm në rast se këto produkte të rrushit për verë kanë EOM-në ose TGJM-në dhe kjo mund të vërtetohet mbi bazën e certifikatës.

Neni 38
Dokumentet shoqëruese

1. Çdo operacion transporti i produkteve të verës që kryhet ndërmjet vreshtarëve, vjelësve, prodhuesve, përpunuesve, mbushësve të shisheve apo tregtarëve, ose prej tyre tek shitësit me pakicë, duhet të shoqërohet nga një dokument shoqërues lëshuar mbi bazë të legjislacionit në fuqi nga institucionet përkatëse.

2. Operatorët e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni duhet të paraqesin dokumentin shoqërues për institucionin e kontrollit zyrtar të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë gjatë gjithë transportit.

3. Dokumenti shoqërues është i vlefshëm vetëm për dërgesën së cilës i jepet.

4. Dokumenti shoqërues përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e dërguesit;

b) numrin e referencës të dërgesës, i cili e identifikon atë në regjistrin e hyrjeve dhe daljeve të dërguesit;

c) emrin e marrësit;

ç) llojin e transportit të përdorur;

d) datën e dërgimit;

dh) vendin e lëvrimit;

e) përshkrimin e produktit;

ë) sasinë e produktit;

f) certifikatat në rast se aplikohet;

g) autoritetin kompetent në vendin e dërgimit.

5. Në përjashtim nga pikat 1–3 të këtij neni, dokumentet shoqëruese nuk nevojiten për produktet e verës që nuk janë objekt i akcizës.

6. Në rastet kur nuk kërkohet një dokument shoqërues, dorëzuesi duhet të jetë në gjendje në çdo kohë të provojë saktësinë e të gjithë informacionit të regjistruar në regjistrin e hyrjeve dhe daljeve, të konfirmuar zyrtarisht nga kontrollet e kryera nga institucioni i kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, si dhe të ketë dokumentacionin që përcaktohet në akte të tjera ligjore e nënligjore.

7. Formati i dokumentit shoqërues miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 39

Certifikimi i origjinës apo i prejardhjes, karakteristikave, vitit të vjeljes ose varieteteve të rrushit dhe EOM-ja ose TGJM-ja

1. I gjithë informacioni në lidhje me certifikatën e origjinës apo të prejardhjes, cilësinë dhe karakteristikat e produktit të verës, të cilat përcaktohen nga grupi i prodhuesve, viti i vjeljes apo varieteti/varietetet e rrushit nga të cilët është prodhuar, dhe EOM-ja apo TGJM-ja, kur kërkohet, përfshirë referencën për certifikatën për EOM-në ose TGJM-në, siç përcaktohet në nenin 26 të ligjit nr. 8/2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore", duhet të përfshihet në:

a) dokumentet shoqëruese, siç përcaktohen në pikën 1 të nenit 38 të këtij ligji; ose

b) të provohet saktësia e informacionit të regjistruar në regjistrin e hyrjeve dhe daljeve, siç përcaktohet në pikën 6 të nenit 38 të këtij ligji.

2. Dorëzuesi apo personi që vepron në emër të dorëzuesit duhet të vërtetojë saktësinë e informacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mbi bazën e regjistrit të hyrjeve dhe daljeve të konfirmuar zyrtarisht nga kontrollet e kryera nga institucioni i kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Neni 40

Eksporti

1. Produktet e verës mund të eksportohen në vendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm të shoqëruara me certifikatën për eksport.

2. Certifikata për eksport, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, lëshohet nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë mbi bazën e:

a) certifikatës së origjinës, lëshuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;

b) certifikatës së shëndetit, bazuar në kontrollet e kryera nga laboratorët e autorizuar;

c) certifikatën e autenticitetit në bazë të certifikatave të përmendura në nenin 39 të këtij ligji.

3. Dorëzuesi apo personi që vepron në emër të dorëzuesit është përgjegjës për lëvrimin e certifikatës së shëndetit dhe certifikatës së autenticitetit pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.

4. Certifikata për eksport vlerësohet të jetë autentike kur vërtetohet nga data dhe nënshkrimi:

a) i dorëzuesit ose një personi të autorizuar që vepron në emër të dorëzuesit; dhe

b) nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.

5. Forma e certifikatës për eksport, që plotësohet nga dorëzuesi ose një person i autorizuar që vepron në emër të dorëzuesit, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, përcaktohet me urdhër ministri.

Neni 41

Importi

1. Produktet e verës që importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të shoqërohen nga një certifikatë cilësie dhe origjine të një institucioni të autorizuar të vendit të eksportit e duhet të plotësojë kërkesat e vendit në të cilin importohen.

2. Importi i produkteve të verës lejohet vetëm nga operatorë biznesi të licencuar për importin e verërave dhe pijeve alkoolike.

3. Verërat e importuara nga vende me të cilat Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje për njohjen e treguesve gjeografikë dhe praktikave enologjike duhet të përmbushin kërkesat për cilësinë të përcaktuara në këtë ligj, përveç kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 42
Mënyra dhe rregullat e raportimit

Rregullat për mënyrën e bashkëpunimit dhe mënyrën e raportimit ndërmjet institucioneve të përcaktuara në nenet 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij ligji përcaktohen me urdhër të ministrit.

KREU VII
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, MASAT DHE EKZEKUTIMI

Neni 43
Kundërvajtjet administrative

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) mosdeklarimi i të dhënave sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji, dhënia e informacionit të pasaktë për vreshtin, emrin e varieteteve të vreshtit apo sinonimet e tyre;

b) prodhimi ose mbushja e shisheve me produkte të rrushit për verë me qëllim shitjeje pa u regjistruar në regjistrin e vreshtarisë, sipas parashikimeve të nenit 12 të këtij ligji, nga rrush i përftuar nga vreshta të paregjistruar në regjistrin e vreshtarisë;

c) mosmbajtja e regjistrave dhe mosplotësimi i dokumenteve shoqëruese të produkteve sipas parashikimeve të neneve 16 e 38 të këtij ligji;

ç) prodhimi për shitje i produkteve nga rrushi për verë prodhuar nga rrush i përftuar nga vreshta në territorin e Republikës së Shqipërisë, në një vendndodhje të ndryshme nga vendi i prodhimit të verës të regjistruar në regjistrin e vreshtave, sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji;

d) mospërmbushja e detyrimeve për tërheqjen e nënprodukteve që rezultojnë nga prodhimi i produkteve të rrushit për verë ose shkaktimi i mbishtypjes së rrushit, sipas parashikimeve të nenit 15 të këtij ligji;

dh) moscertifikimi i produkteve të verës pa EOM-në dhe TGJM-në për të vendosur në etiketë vitin e vjeljes ose emrat e varieteteve të hardhisë ose sinonimet e tyre, sipas parashikimeve të nenit 36 të këtij ligji;

e) hedhja në treg dhe tregtimi i produkteve që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenet 37, 38, 39 dhe 40 të këtij ligji.

ë) ushtrimi i veprimtarisë në kundërshtim me kërkesat e praktikave enologjike të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji.

Neni 44
Sanksionet

Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji merren këto masa administrative:

1. Për shkeljet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 43, gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo hektarë vresht.

2. Për shkeljet e parashikuara në shkronjat "c", "ç", "d", "dh" dhe "e" të nenit 43, gjobë deri në 20% të vlerës së produktit.

3. Për çdo shkelje mund të merret masa e bllokimit të aktivitetit deri në rregullimin e detyrave të lëna dhe parashikimeve ligjore.

4. Për shkeljet e shkronjës "ë" të nenit 43 të këtij ligji, aplikohet masa e asgjësimit në përputhje me ligjin për ushqimin, procedurë që realizohet nga institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Neni 45
Procedura e kundërvajtjeve administrative

1. Konstatimi i kundërvajtjeve administrative të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji dhe vendosja e gjobës bëhet nga institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

2. Kundër vendimit të masës administrative të vendosur nga institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë bëhet ankim në Komisionin e Shqyrtimit të Masave Administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

3. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar nga Komisioni i Shqyrtimit të Masave

Administrative, ekzekutimi dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

4. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Masave Administrative në institucionin e kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë bëhet ankim në gjykatë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 46
Të ardhurat nga vjelja e gjobave

Të ardhurat që krijohen nga vjelja e gjobave kalojnë 100% në buxhetin e shtetit.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 47
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 3; 10, pika 6; 19, pika 5; 31, pika 2, shkronja "b" brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, pika 3; 4, pika 3; 7, pikat 2 dhe 3; 10, pikat 3 dhe 4; 11, pikat 4, 6 dhe 8; 12, pika 6; 13, pika 7; 16, pika 3; 21, pika 6; 24, pika 6; 35; 36, pika 2 ; 40, pika 5; dhe 42 të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për financat të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pika 7, dhe 38, pika 7, të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për mjedisin të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 15, pika 7, të këtij ligji.

Neni 48
Dispozita kalimtare

Produktet e përftuara nga rrushi dhe vera, sipas praktikave enologjike dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8443, datë 21.1.1999, "Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi", të ndryshuar, kur nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, lejohet të tregtohen deri në 2 (dy) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pas këtij afati produktet mund të kalojnë në proces distilimi për alkool ushqimor ose të asgjësohen.

Neni 49
Shfuqizimet

Ligji nr. 8443, datë 21.1.1999, "Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi", i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e tjera që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen pas fillimit të efekteve të këtij ligji.

Neni 50
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet pas 2 vjetëve nga botimi.

Miratuar në datën 22.12.2022.

Shpallur me dekretin nr. 6, datë 11.1.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 6, datë 11.1.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 89/2022

PËR POLICINË BASHKIAKE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon misionin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Policisë Bashkiake në Republikën e Shqipërisë, marrëdhëniet e punës së punonjësit të Policisë Bashkiake, si dhe masat për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike në komunitet.

Neni 2
Misioni

Policia Bashkiake ka si mision ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Drejtuesi i Policisë Bashkiake" është autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe organizativ i Policisë Bashkiake, që përgjigjet drejtpërdrejt para kryetarit të bashkisë për realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuar.

2. "Emërim i punonjësit të Policisë Bashkiake" është momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës për punonjësin e Policisë Bashkiake.

3. "Hapësirat publike" janë hapësirat e jashtme, si: trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi është publik ose privat, si edhe rrugëkalimet publike dhe mjediset që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. "Ministri përgjegjës" është ministri që mbulon fushën e përgjegjësisë për çështjet vendore.

5. "Normat etike detyruese të bashkëjetesës" është tërësia e rregullave që përcaktojnë sjelljen dhe marrëdhënien që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga bashkëpronarët, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, sigurisë së qetësisë dhe veprimtarive të përditshme ekonomike e shoqërore, sipas përcaktimit në legjislacionin për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

6. "Organi disiplinor" është eprori direkt, kryetari i bashkisë dhe komisioni disiplinor, që shqyrtojnë kërkesat për procedim disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake dhe vendosin për masën disiplinore sipas përcaktimeve të këtij ligji.

7. "Sjellja profesionale" ka kuptimin e realizimit të punëve me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë, duke përmbushur objektivat e Policisë Bashkiake dhe duke krijuar marrëdhënie të mira pune me kolegët.

8. "Vërtetim besueshmërie" është akti administrativ, lëshuar nga struktura vendore e Policisë së Shtetit për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruara nga kandidati për punonjës të Policisë Bashkiake, në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore.

9. "Vlerësimi i performancës" është procesi i vlerësimit të rezultateve në punë.

Neni 4
Parimet e veprimtarisë

Parimet bazë, që udhëheqin Policinë Bashkiake në veprimtarinë e saj, janë:

a) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
b) ligjshmëria;
c) mosdiskriminimi;
ç) proporcionaliteti;
d) paanshmëria;

dh) integriteti;
e) merita dhe profesionalizmi;
ë) transparenca;
f) kontrolli dhe llogaridhënia.

KREU II
JURIDIKSIONI, ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT

Neni 5
Juridiksioni

1. Policia Bashkiake është strukturë administrative e bashkisë.
2. Policia Bashkiake ushtron veprimtarinë në territorin e bashkisë përkatëse.

Neni 6
Simbolet

Simbolet që përdor Policia Bashkiake janë flamuri dhe stema e bashkisë.

Neni 7
Organizimi dhe funksionimi i Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake organizohet në strukturë organizative hierarkike në nivel drejtorie ose sektori.
2. Kryetari i bashkisë miraton strukturën dhe organikën e Policisë Bashkiake.
3. Këshilli Bashkiak miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të Policisë Bashkiake.
4. Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 8
Përgjegjësitë dhe detyrat e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi dhe detyra:
a) kontrollon dhe analizon veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
b) raporton para këshillit bashkiak çdo vit dhe sa herë kërkohet prej tij për veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
c) siguron pajisjet, mjetet lëvizëse dhe infrastrukturën e nevojshme për Policinë Bashkiake;
ç) organizon konsultime periodike me komunitetin, organizatat jofitimprurëse dhe me strukturat vendore të Policisë së Shtetit për prioritetet dhe veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
d) miraton kalendarin e trajnimeve të punonjësve të Policisë Bashkiake.

Neni 9
Kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake ka këto kompetenca dhe detyra, në përputhje edhe me aktet e tjera rregullatore:
a) siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak;
b) parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative përmes forcimit, inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj.
2. Në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, Policia Bashkiake:
a) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
b) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
c) vendos kufizimin e qarkullimit në rrugë jashtë qendrave të banuara për ditët e festave lokale në bashkëpunim me organet e Policisë Rrugore;
ç) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të saj;
d) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të bashkisë;
dh) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi

të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë;

e) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të bashkisë;

ë) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;

f) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;

g) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.

3. Në fushën e bashkëjetesës shoqërore, Policia Bashkiake:

a) mbikëqyr respektimin e normave etike detyruese të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

b) mbështet organet e inspektimit për zbatimin e legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;

c) siguron ekzekutimin e sanksioneve për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesave sociale me qira dhe kufizimet mbi banesat me kosto të ulët, të vendosura nga entet menaxhuese.

4. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Policia Bashkiake:

a) bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;

b) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të kontrollit mbi gjuetinë kur pengohen në kryerjen e detyrës;

c) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të inspektimit që mbulojnë veprimtarinë e peshkimit;

ç) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare, brigjeve të tyre, zonave ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to;

d) verifikon dhe kontrollon zbatimin e kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat.

5. Në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe tregtare, Policia Bashkiake:

a) siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;

b) verifikon respektimin e normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje apo vende të autorizuuara nga bashkia të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme dhe vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve;

c) mbështet strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtarinë e tyre.

6. Në fushën e mbrojtjes së shëndetit, Policia Bashkiake siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë dhe mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme.

7. Në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, Policia Bashkiake:

a) siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

b) vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;

c) siguron zbatimin e rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;

ç) garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

Neni 10
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative janë të parashikuara në ligjet e veçanta dhe aktet e këshillit bashkiak.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake për shkeljet e konstatuara merr masa administrative bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që parashikojnë kundërvajtje administrative.

3. Kur punonjësi i Policisë Bashkiake krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik ose juridik përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

4. Procedura për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative nga Policia Bashkiake kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU III
PRANIMI, FORMIMI DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Neni 11
Marrëdhëniet e punësimit të punonjësit të Policisë Bashkiake

Marrëdhëniet e punës së drejtuesit dhe të punonjësve të tjerë të Policisë Bashkiake rregullohen sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës.

Neni 12
Kriteret për pranim në Policinë Bashkiake

Kriteret për pranimin në Policinë Bashkiake të çdo personi janë si më poshtë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;

d) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

e) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;

ë) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

Neni 13
Pranimi në Policinë Bashkiake

1. Pranimi në Policinë Bashkiake bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit.

2. Pranimi kryhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur përmes një procesi përzgjedhës dhe testimi transparent e të drejtë.

3. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e kritereve dhe aftësive profesionale të kandidatëve.

4. Rregullat dhe procedurat e detajuara të pranimit në Policinë Bashkiake përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 14
Shpallja

1. Kryetari i bashkisë shpall pozicionet e lira, të cilat përcaktohen nga drejtuesi i Policisë Bashkiake.

2. Bashkia bën shpalljen e procedurës së pranimit, e cila botohet në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në faqen zyrtare të bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.

3. Shpallja përmban periudhën e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, programin e konkurrimit, fazat e konkurrimit, numrin e vendeve vakante dhe mënyrën e vlerësimit të procesit përzgjedhës.

Neni 15
Konkurrimi dhe komisioni përzgjedhës

1. Konkurrimi përfshin verifikimin paraprak të kandidatit, testimin me shkrim, testimin fizik dhe intervistën nga komisioni përzgjedhës.

2. Komisioni përzgjedhës krijohet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe ka pesë anëtarë:

a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të bashkisë;

b) 2 (dy) anëtarë të zgjedhur nga kryetari i bashkisë, nëpunës civilë, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, njëri prej të cilëve kryeson komisionin;

c) 2 (dy) anëtarë nga Policia Bashkiake.

3. Komisioni përzgjedhës kryen procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për të gjitha fazat, me përjashtim të fazës së testimit fizik, e cila kryhet nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

4. Testimi fizik kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

5. Anëtari i komisionit informon menjëherë kryetarin e bashkisë në rast dyshimi të pengesave ligjore sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, për veten ose për anëtarët e tjerë të komisionit, që të mos marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes.

6. Në rast se anëtarët e përcaktuar të komisionit janë në kushtet e pamundësisë ligjore për të qenë anëtarë të tij, ata zëvendësohen me anëtarë të tjerë nga kryetari i bashkisë.

7. Rregullat e detajuara për funksionimin e komisionit përzgjedhës përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 16
Verifikimi paraprak i kandidatit

1. Komisioni përzgjedhës, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, të përcaktuara edhe në shpalljen për konkurrim.

2. Në përfundim të verifikimit, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në faqen zyrtare të bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.

3. Kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga njësia e burimeve njerëzore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët. që nuk janë kualifikuar, njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore.

Neni 17
Testimi me shkrim

1. Testimi me shkrim shërben për të vlerësuar nëse kandidati zotëron njohuritë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të Policisë Bashkiake.

2. Testimi me shkrim hartohet, administrohet dhe vlerësohet me pikë nga komisioni përzgjedhës.

3. Në përfundim të testimit me shkrim, komisioni publikon zyrtarisht listën me rezultatet e testimit në rend zbritës në faqen zyrtare të bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.

4. Kandidati që ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin me shkrim njoftohet për të vazhduar konkurrimin.

Neni 18
Testimi i aftësive fizike

1. Kandidatët që kalojnë testimin me shkrim i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, i cili teston aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

2. Përmbajtja e testimit të aftësive fizike dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve përgatiten nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

3. Kandidati quhet fitues kur ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin e aftësive fizike.

4. Kandidatët fitues renditen sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm dhe njoftohen për intervistën.

Neni 19
Intervista

1. Kandidati vlerësohet përmes intervistës lidhur me përshtatshmërinë dhe pranueshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës.

2. Komisioni i bën kandidatit pyetje të strukturuara, të cilat testojnë formimin dhe aftësitë e tij.

Neni 20
Përfundimi i procesit të konkurrimit

1. Procedura e konkurrimit përfundon me intervistën. Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, komisioni liston kandidatët fitues.

2. Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen përkatësisht:

a) testimi me shkrim, 60 (gjashtëdhjetë) pikë;

b) testimi i aftësive fizike, 20 (njëzet) pikë;

c) intervista, 20 (njëzet) pikë.

3. Kandidatët renditen në listën përfundimtare sipas rezultateve të arritura në rend zbritës, sipas pikëve totale të marra.

4. Administrimi i listës së fituesve të nxjerrë nga Komisioni Përzgjedhës bëhet nga njësia e burimeve njerëzore të bashkisë.

5. Lista e kandidatëve, që kanë rezultuar të suksesshëm, është e vlefshme për 1 (një) vit, duke filluar nga data e përfundimit të procesit të pranimit.

Neni 21
Ankimi

1. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komisionin Përzgjedhës për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga:

a) data e njoftimit individual të rezultatit të verifikimit paraprak të kandidatit;

b) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit me shkrim;

c) data e njoftimit individual të rezultatit të testimit të aftësive fizike;

ç) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve për kandidatët, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të përcaktuara.

2. Komisioni përzgjedhës njofton vendimin brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor.

3. Në përfundim të këtij afati, njësia e burimeve njerëzore publikon listën përfundimtare fituese.

Neni 22
Emërimi i punonjësit të Policisë Bashkiake

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake emërohet nga kryetari i bashkisë, pas shpalljes fitues nga procedura e konkurrimit.

2. Procedura e përzgjedhjes për kandidatët me eksperiencë në Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi përfshin vetëm fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve dhe intervistën nga komisioni përzgjedhës

3. Pas emërimit, punonjësi i Policisë Bashkiake i nënshtrohet periudhës tremujore të provës.

4. Punonjësi i Policisë Bashkiake gjatë periudhës së provës përfundon trajnimin e detyrueshëm 4-javor në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, sipas programit të miratuar për këtë qëllim nga institucioni arsimor.

5. Në përfundim të trajnimit të detyrueshëm, zhvillohet testimi me shkrim për përvetësimin e njohurive nga kandidati, bazuar në programin e trajnimit. Kandidati përfundon me sukses trajnimin e detyrueshëm nëse merr mbi 50% të pikëve të testimit.

6. Mospërfundimi me sukses i trajnimit të detyrueshëm përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës.

7. Në fund të periudhës së provës, duke u bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë dhe përfundimin me sukses të trajnimit të detyrueshëm, punonjësi i Policisë Bashkiake konfirmohet në detyrë. Ndaj vendimit për vlerësimin e rezultateve në punë, punonjësi në periudhë prove ka të drejtë të kërkojë shqyrtim të vlerësimit nga drejtuesi i Policisë Bashkiake.

Neni 23
Kriteret për emërimin e drejtuesit të Policisë Bashkiake

1. Kandidati për drejtues të Policisë Bashkiake, përveç kritereve të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, plotëson edhe kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë ose të ketë diplomë të barasvlershme me të ose të ketë përfunduar studimet e arsimit të lartë jashtë vendit dhe të ketë njohur dhe njësuar diplomën sipas përcaktimeve për njësimin e diplomave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike ose institucionet arsimore të sigurisë;

b) të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;

c) të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

2. Procedura e përzgjedhjes për drejtuesin e Policisë Bashkiake është e njëjtë sikurse për punonjësin, por përfshin vetëm fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve, testimin me shkrim dhe intervistën nga komisioni përzgjedhës.

3. Emërimi i drejtuesit të Policisë Bashkiake bëhet nga kryetari i bashkisë sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24
Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtuesit të Policisë Bashkiake

Drejtuesi i Policisë Bashkiake ushtron këto përgjegjësi dhe detyra:

a) organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka Policia Bashkiake;

b) koordinon veprimtarinë e punës me Policinë e Shtetit për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë;

c) planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuar;

ç) kryen analiza, raporte, përshkrime që lidhen me veprimtarinë e Policisë Bashkiake;

d) i propozon kryetarit të bashkisë kalendarin e trajnimeve për të siguruar kualifikimin periodik profesional të punonjësve të Policisë Bashkiake;

dh) këshillon kryetarin e bashkisë dhe jep mendime për zgjidhjen e çështjeve në fushën e përgjegjësisë së tij.

Neni 25
Lirimi dhe shkarkimi i drejtuesit dhe punonjësve të Policisë Bashkiake

1. Drejtuesi dhe punonjësi i Policisë Bashkiake lirohet nga detyra në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;

c) bëhet i paaftë përgjithmonë për të kryer detyrën për shkak të gjendjes shëndetësore;

ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;

d) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij.

2. Lirimi dhe shkarkimi i drejtuesit të Policisë Bashkiake bëhet nga kryetari i bashkisë.

3. Drejtuesi dhe punonjësi i Policisë Bashkiake shkarkohet nga detyra në rastet kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) merret masa disiplinore e largimit nga Policia Bashkiake pasi kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

c) humbet shtetësinë shqiptare;

ç) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

4. Lirimi dhe shkarkimi i punonjësit të Policisë Bashkiake bëhen nga kryetari i bashkisë, me propozimin e drejtuesit të Policisë Bashkiake, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

5. Për rastin e përcaktuar në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij neni, shkarkimi i punonjësit të Policisë Bashkiake bëhet nga kryetari i bashkisë, me propozim të Komisionit të Disiplinës.

Neni 26
Vlerësimi i performancës

1. Vlerësimi i rezultateve në punë përfshin verifikimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të punonjësit të Policisë Bashkiake.

2. Vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësit të Policisë Bashkiake bëhet çdo vit nga eprori i

drejtpërdrejtë dhe miratohet nga drejtuesi i Policisë Bashkiake.

3. Punonjësi i Policisë Bashkiake vlerësohet në një nga këto nivele:

a) jokënaqshëm, në rastet kur punonjësi nuk i ka realizuar objektivat dhe nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me qëndrimin dhe sjelljen profesionale;

b) kënaqshëm, në rastet kur punonjësi ka realizuar kënaqshëm objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional relativisht të mirë;

c) mirë, në rastet kur punonjësi ka realizuar mirë objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të mirë;

ç) shumë mirë, në rastet kur punonjësi ka realizuar shumë mirë të gjitha objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të dalluar nga të tjerët.

4. Rregullat e detajuara për procedurën e vlerësimit dhe formati i formularit të vlerësimit të rezultateve të punës përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

5. Punonjësi i Policisë Bashkiake, kur nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ka të drejtë të kërkojë shqyrtim të vlerësimit nga drejtuesi i Policisë Bashkiake.

6. Drejtuesi i Policisë Bashkiake shqyrton ankimin brenda 5 (pesë) ditëve dhe bën vlerësimin përkatës, i cili shënohet dhe nënshkruhet nga ky i fundit në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë.

7. Pas përfundimit të ankimit administrativ, punonjësi ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 27
Trajnimet

1. Trajnimet e punonjësit të Policisë Bashkiake bëhen në mënyrë periodike në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ose në institucione të tjera publike.

2. Bashkitë bashkëpunojnë me institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni për miratimin dhe zbatimin e programit të formimit të vazhdueshëm, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale.

3. Kostot e trajnimit përballohen nga buxheti i bashkisë.

Neni 28
Trajtimi financiar gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës

1. Paga e punonjësit të Policisë Bashkiake miratohet nga këshilli bashkiak në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat dhe shpërblimet.

2. Shpenzimet për pagat dhe shpenzimet e tjera përballohen nga buxheti i bashkisë.

KREU IV
DETYRIMET DHE TË DREJTAT E PUNONJËSIT TË POLICISË BASHKIAKE

Neni 29
Detyrimi për respektimin e ligjit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake respekton Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe mbron të drejtat e liritë e njeriut.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake mban përgjegjësi individuale për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Punonjësi i Policisë Bashkiake kryen detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi dhe pa diskriminim.

Neni 30
Detyrimi për të zbatuar urdhrin

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake vepron në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të bashkisë.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake, nëse dyshon për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton atë, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.

3. Punonjësi i Policisë Bashkiake zbaton urdhrin me shkrim, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.

Neni 31
Detyrimi për të zbatuar rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake respekton rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave, të cilat përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.
2. Gjatë ushtrimit të detyrave të tij, punonjësi i Policisë Bashkiake i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 32
Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk përdor informacionin e mbledhur gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake siguron mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atyre që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të personave, të mbrojtura sipas ligjit, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës, edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

Neni 33
Detyrimi për administrimin e pronës dhe kohën e punës

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake miradministron pronën, pajisjet dhe mjetet që i vihen në përdorim në ushtrimin e detyrës dhe i përdor ato vetëm për qëllimin e përcaktuar.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake shfrytëzon kohën e punës dhe shërbimit me efektshmëri dhe vetëm për kryerjen e detyrave.

Neni 34
Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk punësohet ose kryen veprimtari private që bie ndesh me detyrën e punonjësit të Policisë Bashkiake, me përjashtim të mësimdhënies.
2. Në rastet e mësimdhënies, punonjësi i Policisë Bashkiake merr miratimin me shkrim të drejtuesit.

Neni 35
Konflikti i interesit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake shmang çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës sipas legjislacionit përkatës.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake informon menjëherë eprorin në rast dyshimi për një konflikt interesi dhe zbaton urdhrat e tij.
3. Eprori merr masa të shmangë konfliktin e interesit të deklaruar nga punonjësi.

Neni 36
Të drejtat politike

1. Policia Bashkiake është strukturë e depolitizuar.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk mund të jetë anëtar i partive politike.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk duhet të shprehë publikisht bindjet ose preferencat e tij politike gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

Neni 37
E drejta e anëtarësimit në organizata sindikale

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtën e pjesëmarrjes në organizata sindikale dhe veprimtari sindikale, që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tij në marrëdhënien e punës.
2. Marrëdhëniet ndërmjet organizatave sindikale dhe punonjësve të Policisë Bashkiake rregullohen nëpërmjet statutit të sindikatës dhe kartës së të drejtave dhe detyrimeve që pranon çdo punonjës i Policisë Bashkiake kur anëtarësohet.

KREU V
PROCEDIMI DISIPLINOR NË POLICINË BASHKIAKE

Neni 38
Shkeljet disiplinore

1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të Policisë Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, që bie në

kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nëse ajo nuk përbën vepër penale.

2. Shkeljet disiplinore janë:

a) shkelje të lehta;

b) shkelje të rënda.

3. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 3 (tre) vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.

Neni 39
Llojet e shkeljeve disiplinore

1. Janë shkelje të rënda:

a) mospërmbushja e detyrave;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustifikuar dhe e vijueshme për 3 (tri) ditë pune ose më shumë;

c) shkelja e përsëritur e rregullave të etikës;

ç) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;

d) dëmtimi me dashje i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të mjeteve lëvizëse apo pajisjeve të Policisë Bashkiake për interesa private ose lejimi i përdorimit të tyre prej personave të tjerë;

dh) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të detyrës që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të statusit si punonjës i Policisë Bashkiake;

e) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla;

ë) moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të eprorëve, kur kanë sjellë pasoja;

f) ushtrimi i detyrës në kushtet e konfliktit të interesit;

g) shkelja e kërkesave dhe e rregullave për garantimin e rendit dhe të sigurisë në komunitet;

gj) paraqitja në detyrë ose shërbim nën efektet e alkoolit ose të lëndëve narkotike apokonsumimi i tyre gjatë kryerjes së detyrës;

h) mosmarrja e masave nga eprorët për rastet e konstatuara të ngacmimeve seksuale ose për të cilat është vënë në dijeni;

i) lejimi i përdorimit të dokumentit të identifikimit nga persona të tjerë;

j) mospërdorimi i uniformës dhe shenjave dalluese gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;

k) mosinformimi i eprorëve për fillimin e procedimit penal ndaj tij;

l) përsëritja e një shkeljeje të lehtë disiplinore për të cilën është në fuqi një masë disiplinore.

2. Janë shkelje të lehta:

a) mungesa e pajustifikuar në punë deri në 3 (tri) ditë pune;

b) shkelja e rregullave të etikës për Policinë Bashkiake;

c) sjellja e parregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;

ç) moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të eprorëve;

d) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e detyrës së një punonjësi tjetër të Policisë Bashkiake;

dh)komunikimi me medien apo me persona të tjerë pa miratimin e drejtuesit të Policisë Bashkiake;

e) mbajtja apo përdorimi i dokumentit identifikues të pamiratuar nga autoriteti përkatës, si punonjës i Policisë Bashkiake;

ë) kryerja e akteve dhe sjelljeve të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskretitojnë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Bashkiake ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në Policinë Bashkiake.

Neni 40
Procedura disiplinore

1. Masat disiplinore merren nga organi disiplinor sipas një procedure transparente, e cila i garanton punonjësit të Policisë Bashkiake të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Për shkelje të lehta disiplinore masa merret nga eprori direkt për punonjësin e Policisë Bashkiake, ndërsa për drejtuesin e Policisë Bashkiake nga kryetari i bashkisë.

3. Për shkelje të rënda disiplinore masa merret nga Komisioni i Disiplinës për drejtuesin dhe punonjësin e Policisë Bashkiake.

4. Komisioni i Disiplinës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka në përbërje:

a) nëpunësin më të lartë civil në bashki;

b) eprorin direkt të punonjësit për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të bashkisë;

ç) nëpunësin më të vjetër të administratës së bashkisë;

d) punonjësin më të vjetër në strukturën e Policisë Bashkiake.

5. Komisioni i Disiplinës ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe mblidhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

6. Rregullat e hollësishme për procedimin disiplinor në Policinë Bashkiake përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 41
Fillimi i hetimit disiplinor

1. Hetimi disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake fillon kryesisht ose me ankesë, bazuar në informacione prej të cilave lindin dyshime të arsyeshme mbi kryerjen e një shkeljeje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Eprori direkt vlerëson paraprakisht informacionin e marrë për shkeljen e pretenduar. Nëse nuk rezulton të ketë elemente që mund të përcaktohen si shkelje disiplinore, vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore.

3. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente që përcaktohen si shkelje disiplinore, eprori direkt bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 2 të nenit 38 të ligjit.

4. Në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon procedurën disiplinore dhe në rast se shkelja klasifikohet e rëndë, procedura disiplinore fillon nga Komisioni Disiplinor.

5. Organi disiplinor fillon procedimin disiplinor dhe njofton me shkrim punonjësin përkatës.

Neni 42
Zhvillimi i procedimit disiplinor

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit dhe atij i garantohet aksesi në dosjen e hetimit.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtën për t'u dëgjuar ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë e prova ose për të kërkuar marrjen e tyre.

3. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtë për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar.

4. Organi disiplinor për dhënien e masës disiplinore i kërkon punonjësit të Policisë Bashkiake të paraqesë çdolloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

5. Organi disiplinor, pasi shqyrton çështjen, vendos marrjen e masës disiplinore, mosmarrjen e masës disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

Neni 43
Ndërprerja e ecurisë disiplinore

1. Organi disiplinor mbyll hetimin dhe ndërpret ecurinë disiplinore nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm, që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi për shkak të kalimit të afateve;

ç) punonjësi i Policisë Bashkiake ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjykate.

2. Organi disiplinor i njofton vendimin për ndërprerjen e ecurisë disiplinore titullarit të institucionit, punonjësit të Policisë Bashkiake ose përfaqësuesit të tij, i cili përmban arsyet për mbylljen e hetimit sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 44
Masat disiplinore

1. Ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake, që kryen shkelje disiplinore, merren këto masa:

a) për shkelje të lehta disiplinore:

i. vërejtje;

ii. vërejtje me paralajmërim.

b) për shkelje të rënda disiplinore:

i. mbajtjen deri në 1/4 e pagës së plotë për një periudhë deri në tre muaj;

ii. largimin nga Policia Bashkiake.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Në rastin kur kemi më shumë se një shkelje disiplinore dhe kur shkeljet e konstatuara sanksionohen me masa të ndryshme disiplinore, jepet masa më e rëndë.

3. Marrja e masës disiplinore bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshtësia e kryerjes së shkeljes;

c) rrethanat e kryerjes së shkeljes, mundësia e ardhjes së pasojave, si dhe dëmi i shkaktuar nga shkelja.

4. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:

a) 6 (gjashtë) muaj për masën "vërejtje" dhe "vërejtje me paralajmërim";

b) 3 (tre) vjet nga njoftimi i masës së parashikuar sipas nënndarjes "i" të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni.

5. Masa disiplinore "Largim nga Policia Bashkiake" qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit të Policisë Bashkiake.

6. Deklarimi i shuarjes bëhet kryesisht apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të bashkisë dhe masa fshihet nga dosja e personelit.

Neni 45
Ankimi

1. Vendimi jepet me shkrim, i arsyetuar, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtë ta ankimojë vendimin për masën disiplinore në gjykatën kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VI
UNIFORMA, SHENJAT DALLUESE, PAJISJET DHE MJETET

Neni 46
Uniforma dhe shenjat dalluese

1. Punonjësi kryen detyrat e shërbimit me uniformë dhe shenja dalluese të veçanta.

2. Stema dhe shenjat dalluese përdoren në uniformën e Policisë Bashkiake.

3. Punonjësi i Policisë Bashkiake përdor uniformën dhe shenjat dalluese vetëm gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.

4. Punonjësi i Policisë Bashkiake gjatë kryerjes së detyrës identifikohet me dokumentin individual të identifikimit.

5. Policia Bashkiake në çdo bashki ka uniformë të njëjtë, të ndryshme nga çdo strukturë tjetër policore.

6. Uniforma, shenjat dalluese dhe modeli i dokumentit individual të identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47
Mjetet e Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës përdor mjete lëvizëse.

2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim ngjyrën, shenjën dhe përdorimin e tyre.

KREU VII
MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE NË KOMUNITET

Neni 48
Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake kontrollon identitetin e personit, kur:

a) në gjendjen e flagrancës konstatohet se po kryen një kundërvajtje administrative;

b) ndaj tij është paraqitur një kërkesë me dyshimin se është kryer një shkelje administrative;

c) është i dyshuar për cenim të rendit dhe sigurisë në komunitet, për kompetencat dhe detyrat e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i Policisë Bashkiake bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.

3. Gjatë procedurës së verifikimit, Policia Bashkiake ka të drejtë të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kontrollin e identitetit, sipas rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 49
Bllokimi i rrugëve

Për nevoja të rendit dhe të sigurisë publike ose në rastet e fatkeqësive natyrore apo të aksidenteve, Policia Bashkiake vë në dispozicion të Policisë së Shtetit punonjësit e saj dhe mjetet për bllokimin e një pjese të rrugëve ose të mjediseve publike

brenda juridiksionit të bashkisë deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

Neni 50
Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit me çrregullime të shëndetit mendor, në gjendje të dehur ose nën efektet e lëndëve narkotike.
2. Në këto raste, punonjësi i Policisë Bashkiake njofton Policinë e Shtetit dhe, në rastet kur gjendja e tij përbën rrezik për jetën e tij, shëndetin ose sigurinë e vetes ose të të tjerëve, e shoqëron personin në shërbimin e urgjencës mjekësore më të afërt.
3. Veprimet e sipërpërmendura për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në pikën 1 të këtij neni dokumentohen në procesverbal.

Neni 51
Bashkërendimi me organet publike

1. Policia Bashkiake bashkëpunon dhe bashkërendon punën me organet publike, personat juridikë dhe fizikë, në përmbushje të detyrave funksionale, të përcaktuara edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.
2. Policia Bashkiake bashkërendon punën me Policinë e Shtetit në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në funksion të parandalimit të krimit në bashkinë përkatëse.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 52
Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 4, nenit 46, pika 6, dhe nenit 47, pika 2, të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 53
Shfuqizime

Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 54
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2022.

Shpallur me dekretin nr. 5, datë 11.1.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 5, datë 11.1.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 89/2022, "Për Policinë Bashkiake".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 2, datë 11.1.2023

PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMET E LEGALIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për

sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet e legalizuara në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Elbasan, Kamzë–Vorë, Tiranë Rurale 1, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Shkodër, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale 2, Zonat e Stimuluara, Lezhë, Kavajë dhe Sarandë.

2. Vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 440 125 488,09 (katërqind e dyzet milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë presje zero nëntë) lekë, për sipërfaqen 50 927,5 (pesëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë presje pesë) m², sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi për pasuritë me numrat rendorë, sipas kolonës 14, të shtojcës 1, përkatësisht: nr. 18, nr. 41, nr. 59, nr. 78, nr. 79, nr. 128, nr. 131, nr. 134, nr. 144, nr. 150, nr. 158, nr. 169, nr. 171, nr. 180, nr. 181, nr. 188, nr. 191, nr. 193, nr. 205 dhe nr. 207, sipas seksionit të veçantë (kolona 19) të shtojcës 1, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, sipas pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

4. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen.

5. Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, Kamzë–Vorë, Tiranë Rurale 1, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Shkodër, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale 2, Zonat e Stimuluara, Lezhë, Kavajë, dhe Sarandë të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

6. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Belinda Balluku

AGJENSIA SHTETERORE E KADASTRES

LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar										Kompensimi i Pronarëve								
Nr. Rendor	Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit		Gjendja juridike (pronesia)	Pjesa baloneze në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Numuri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
				Numer	Date													
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16.00	17	18	19
ELBASAN																		
QARKU ELBASAN,ZONA KADASTRALE 2924 PRRENJAS																		
1	ISAK	PASHO	HANA	694	26/05/2021	Pronar		206.7	1	ESMIHANE	SH.	KOKONOZI	1	5/473	206.70	2,898	599,016.60	
									2	RAMAZAN	SH.	KOKONOZI						
									3	IBRAHIM	SH.	KOKONOZI						
									4	BASHKIM	SH.	KOKONOZI						
									5	SHADIJE	SH.	KOKONOZI						
									6	FATIME	SH.	KOKONOZI						
									7	ALMA	XH.	KOKONOZI						
									8	ROLAND	XH.	KOKONOZI						
QARKU ELBASAN,ZONA KADASTRALE 3203 RRAJCE																		
2	NDRIÇIM	SALI	BOGDANI	803	23/06/2021	Pronar		232.5	9	MEXHIT	ISAK	MOLLA	2	151/56	232.50	179	41,617.50	
3	PETRIT	VELI	ÇUKU	804	23/06/2021	Pronar		282	10	SULEJMAN	LATIF	ÇUKU	3	269/13	282.00	179	50,478.00	
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8521																		
4	ARBEN	EMIN	BUZANI	211	9/8/2021	Pronar+Shtet			11	QAZIM	XHEMALI	BYLYKBASHI	4	3/62	51.50	13,666	703,799.00	
	SELIME	DALIP	KOKLA						12	FERZILET	ZYHDI	SARJA						
									13	ARMAND	FUAT	BYLYKBASHI						
									14	MYZEJEN	ISMAIL	BYLYKBASHI						
									15	ZEGJINE		GJATA						
									16	MYRTEZA		KARDHASHI						
									17	SUZANA		BAKALLI						
									18	BURBUQE		GARUNJA						
									19	ENERIETA		MALKJA						
									20	HYSEN		KARDHASHI						
									21	BUKUROSH	MUSTAFA	GJATA						
									22	FLORESHA	ISUF	GJERGJI						
									23	OSMAN	SULEJMAN	ARAPI						
									24	ENGJELLUSHE	MUSTAFA	DHIMITRI						
									25	ARTUR	XHEMIL	GJERGJI						
									26	GERTI	XHEMIL	GJERGJI						
									27	AGRON	MUSTAFA	GJATA						
									28	MUSTAFA	SULEJMAN	ARAPI						
									29	ZEDLIR	FUAT	BYLYKBASHI						
									30	MAKBULE	SULEJMAN	SAMARXHIU						
									31	RAIMONDA	SULEJMAN	SHEHETILA						
									32	FLORA	ALI	SPAHIU						
									33	ALTIN	NDRIÇIM	GJATA						
									34	ADELA	NDRIÇIM	GJATA						
									35	RUDINA	NDRIÇIM	GJATA						
									36	HALIME		GJATA						
QARKU ELBASAN , ZONA KADASTRALE 2446 LIBRAZHD																		
